



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 07.11.2014, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e shtetit të vitit 2015”.
3. Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Tahir Muhedini, Spartak Braho, Nard Ndoka, Silva Caka, Mark Frroku dhe Dashamir Peza.

Mungojnë:

Edi Paloka, Oerd Bylykbashi, Blendi Klosi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Kastriot Islami, Mhill Fufi, Armando Prenga, Tom Doshi, Piro Lutaj, Keltis Kruja, Eduard Halimi dhe Gent Strazimiri.

Të ftuar:

1. Shkëlqim Cani - ministër i Financave
2. Gelardina Prodani - sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Financave
3. Mimoza Dhembli - drejtoreshë e Përgjithshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave
4. Fran Ibrahim - drejtor në Drejtorinë e Monitorimit dhe Zbatimit të Buxhetit në Ministrinë e Financave

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Përshëndetje!

Sot do të fillojmë shqyrtimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e shtetit të vitit 2015”. Pa dyshim kjo është ngjarja më e rëndësishme në veprimtarinë e një parlamenti për arsyet që dihen, por edhe për atë çfarë përfaqëson buxheti për shtetin e për qytetarët. Kjo është arsyeja që Rregullorja e Kuvendit dhe Kushtetuta kanë përcaktuar një procedurë të veçantë për shqyrtimin e buxhetit dhe të paketës fiskale për shkak të rëndësisë që ka kjo vendimmarrje për ligjvënësin, por edhe të pritshmërisë së madhe që kanë qytetarët.

Ne do të shqyrtojmë sot në parim projektligjin “Për buxhetin e shtetit të vitit 2015”, sipas kalendarit që kemi miratuar dje. Më pas do të shqyrtojmë në parim edhe një nga projektligjet e paketës fiskale, konkretisht atë “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”, sepse ky ishte i vetmi projekt që trajtonte çështje që kanë të bëjnë me fushën e veprimtarisë së këtij komisioni .

Në ditët në vijim do të zhvillojmë seanca dëgjimore për projektbuxhetin me të gjitha institucionet që janë pjesë e fushës së veprimtarisë së komisionit tonë. Natyrisht do të ftojme edhe institucionet e pavarura, një përvojë tashmë e konsoliduar në veprimtarinë e këtij komisioni. Pasi të miratojmë në parim buxhetin dhe paketën fiskale në datën 17 nëntor në seancë plenare, do të kalojmë në shqyrtimin nen për nen të projektligjit të buxhetit dhe atij për taksat kombëtare, duke miratuar në fund raportin që do t’i dërgojmë Komisionit të Ekonomisë, që është edhe komision përgjegjës, për t’i reflektuar në shqyrtimin nen për nen të buxhetit.

Për shqyrtimin e këtyre dy projektligjeve kanë ardhur: zoti Shkëlqim Cani, ministër i Financave; zonja Geraldina Prodani, sekretare e Përgjithshme; zonja Mimoza Dhëmbi, drejtoreshë e Përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, personazh shumë miqësor, por edhe jo aq miqësor në këtë komision, por i domosdoshëm; si dhe zoti Ibrahim, drejtor në Drejtorinë e Monitorimit dhe Zbatimit të Buxhetit.

Zoti Ministër, faleminderit për prezencën!

Unë mendoj se do të ishte mirë që ministri pas prezantimit të projektbuxhetit të na bënte edhe një paraqitje të projektligjit “Për taksat kombëtare”, meqenëse do të jetë pjesë e paketës.

Relator për çështje të kësaj natyre, si gjithmonë, është zoti Fino.

Kështu që nën drejtimin e relatorit do të vazhdojmë më tej procesin, sidomos me seancat dëgjimore, por edhe gjatë shqyrtimit nen për nen.

Zoti Ministër, fjala është për ju.

Shkëlqim Cani – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Komisionit të Ligjeve,

Natyrisht, ashtu siç e thatë edhe ju, çështja e miratimit të projektbuxhetit të vitit 2015 është mjaft e rëndësishme për axhendën e Kuvendit. Kuptohet që ne si Ministri e Financave bashkë me ministritë e tjera, me të cilat kemi bashkëpunuar, si dhe me ngjyrimin e fundit që i ka dhënë qeveria jemi përpjekur që në projektbuxhetin e vitit 2015 të pasqyrojmë dhe të reflekojmë në optimumet e veta mundësitë që ka ekonomia si në trajtimin e të ardhurave, kryesisht me paketën fiskale, por edhe në pjesën e shpenzimeve, duke u munduar që të gjejmë atë që është e arsyeshme edhe në shpenzimet e të gjithë buxhetit të shtetit, po kështu edhe në shpenzimet e buxhetit vendor. Për më shumë detaje, kuptohet që në interes më të ngushtë, do të përmend organet e drejtësisë.

Unë do t'i bëj një panoramë relativisht të shkurtër buxhetit të vitit 2015, pasi relacioni me pasqyrat përkatëse ka mbërritur prej ditësh në Kuvend. Kuptohet që një relacion me 60 faqe jep detaje në mënyrë të ftohtë për çështje që në vetvete mund të jenë edhe të nxehta, sepse ekonomia ka momente pozitive, por edhe vështirësitë e veta, të cilat kanë vijuar nga e kaluara, por edhe janë krijuar gjatë kohës. Kështu që duke i ndjekur me vëmendje të gjitha momentet, ne jemi munduar që të ardhmen dhe këtë buxhet për vitin 2015, meqë për herë të parë vjen edhe buxheti afatmesëm 2015-2015, ta shohim me optimizëm. Si ministër i Financave në emër të qeverisë them me bindje se ky është një buxhet sa realist, aq edhe optimist për të ardhmen e ekonomisë shqiptare, në ndihmë të realizimit të programit të qeverisë.

Cilat janë katër objektivat madhorë dhe kryesorë të buxhetit të vitit 2015?

Së pari, ky buxhet synon të realizojë një mbështetje të zhvillimit të vendit, të rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe të punësimit.

Së dyti, buxheti mundohet që të ulë dhe të shmangë sa të jetë e mundur më shumë rreziqe ose sfida që, në mënyrë të natyrshme, ekonomi të zhvilluara, të pazhvilluara apo në zhvillim, siç është vendi ynë, tentojnë ta pengojnë rritjen. Këtu dua të përmend dy çështje madhore që kërkon të adresojnë ky buxhet: borxhin publik dhe energjinë. Ashtu siç jemi zotuar si qeveri e koalicionit, duke marrë mbështetjen e ju të gjithëve si deputetë, që në vitin 2015 do të fillojë ulja e borxhit dhe kështu është realizuar. Ndërkohë, duke qenë se janë një varg reformash strukturore të ekonomisë, reforma që në mënyrë të përsëritur kemi thënë se janë sa thelbësore, aq edhe komplekse e të thella, ndër to ndoshta më e rëndësishmja, ky është mendim personal, dhe ndoshta më e vështira në vargun e reformave është ajo në energjetikë,

sepse është shumë komplekse dhe kërkon një mbështetje jo vetëm nga ministria që merret me energjetikën, por nga i gjithë grupi i ministrive që mbulojnë ekonominë. Në rastin konkret është marrë mbështetja edhe nga ministrinë përkatëse, sepse, në fakt, është marrë mbështetja e qeverisë dhe tani në krye të grupit është edhe vetë Kryeministri. Kështu që ky buxhet i ka dhënë një mbështetje relativisht të fuqishme energjetikës, pasi janë dhënë afërsisht 20 miliardë lekë ose 200 milionë dollarë, një shifër e paparë për mbështetjen e këtij sektori.

Së treti, buxheti jep mbështetje dhe merr mbështetje nga një sërë reformash të tjera. Pra, veç reformës së energjisë janë edhe reforma të tjera, si ajo e pensioneve, ajo administrativo-territoriale, e cila e ka marrë tashmë vulën nga parlamenti, por kërkon të zbërthehet më në detaje në vitin 2015, që është një vit tranzicioni dhe vështirësish për arsye se një administratë e vjetër lë pushtetin, ndërkohë ngrihet një administratë e re, e cila është tërësisht e riorganizuar. Nuk flasim për dy-tri ndryshime, por pothuajse për një përmbysje të administratës lokale jo vetëm në mentalitet, por edhe në vetë funksionet e saj dhe në aspektin e organizimit; ulet shumë numri i njësive administrative në vend. Po kështu, kemi reformën e mbrojtjes sociale etj.

Së fundi, ky buxhet synon përmirësimin cilësor të shërbimeve publike. E përmend këtë, pasi në vetvete taksat, të ardhurat në tërësi jo vetëm nga taksat, por edhe jashtë tyre, grumbullohen me një qëllim, që të shpenzohen në dobi të shtetasve shqiptarë dhe të ekonomisë shqiptare. Këndvështrimi sesi shkojnë shpenzimet, si përdoren dhe si përmirësohet shërbimi ndaj individit, ndaj publikut, ndaj konsumatorit merr rëndësi të madhe, kështu që ky është një nga objektivat e tjerë madhorë që kërkon të zgjidhë ky buxhet.

Lidhur me rritjen ekonomike, kërkoj ndjesë që nuk kemi mundur ende të kemi projektorin, në mënyrë që secili prej nesh të shihte të projektuar sesi ka shkuar deri tani rritja e ekonomisë dhe si do të shkojë gjatë tre vjetve të ardhshëm. Natyrisht që ky grafik jep dukshëm një tendencë uljeje gjatë katër vjetve të shkuar, ndërkohë që jep dukshëm një tendencë rritjeje gjatë katër vjetve që do të vijnë. Pra, në kompleksin e tyre rritjet ekonomike shkojnë nga 3,7% në 1,4% dhe nga 1,4% në 2,1% këtë vit, në 3% në vitin 2015, pastaj në 4%-4,5% në vitet deri në përfundim të mandatit.

Cila është fabula e kësaj?! Shqipëria me këtë buxhet, natyrisht jo vetëm si faktor i buxhetit, kërkon të shkojë te rritja ekonomike e dikurshme, në mënyrë që, ashtu si të gjitha vendet e tjera, të mund të gëzojë të mirat e rritjes ekonomike, një prej të cilave është edhe punësimi. Njëkohësisht, me rritjen ekonomike, edhe pse është disi e vështirë të realizohen të dyja, ajo që merr rëndësi është ulja e borxhit. Borxhi publik është një barrë e rëndë në supet e çdo shqiptari, për arsye se vetëm shërbesa e borxhit të një viti është disi më e madhe nga vetë

totali i investimeve që shkojnë për buxhetin e një viti. Pra, ne na duhet çdo vit të shlyejmë norma interesi pothuajse të barabarta ose më të larta se të gjitha investimet që ka buxheti, flas për investimet e brendshme.

Si do të shkojë trajektorja e borxhit? Nga rritje, që ka qenë në të gjitha vitet, duke filluar nga viti 2008, natyrshëm do të fillojë ulja nga viti 2015, ashtu siç është në programin e qeverisë dhe siç jemi zotuar, për të arritur në vitin 2017 në një nivel prej 65,5%. Në qoftë se do të vijojmë më tej, synimi nuk është vetëm për të arritur 60% në vitin 2019, por për të shkuar edhe poshtë 60% me tentativë për të arritur nivelin 50%-40%, aty ku janë mundësitë optimale të një ekonomie si e jona. Gjithsesi, ky synim i takon një perspektive afatgjatë.

Kjo është ajo që synohet. Meqenëse ka këndvështrime të ndryshme sesi shihet sot gjendja e ekonomisë, performanca e vitit 2014 dhe pritshmëritë për vitet 2015, 2016, 2017, synojmë që kjo frymë optimizmi dhe kjo dëshirë e qeverisë shqiptare, e Ministrisë së Financave në këtë buxhet të mos jetë vetëm këndvështrimi i një grupi njerëzish, por të jetë i të gjithë komunitetit ndërkombëtar dhe i grupit të pavarur. Pra, qeveria sheh me optimizëm ekonominë në të ardhmen, si dhe realizimin e vitit 2014. Por si e sheh, për shembull *Standards and Poors*, e cila është një kompani ndërkombëtare që merret me vlerësimin e ekonomive në të gjithë botën dhe është e pranuar nga të gjithë?! *Standards and Poors* në botimin e fundit (ata që janë ekonomistë, por edhe juristët e kuptojnë që faktori bazë për të marrë vlerësime pozitive është niveli i borxhit, i cili në Shqipëri në vitin 2014 është në një nivel relativisht të lartë) dha vlerësim pozitiv për ekonominë shqiptare.

Tjetër tregues ndërkombëtar i organizmave ndërkombëtare është “Doing Business”, që botohet nga IFC-ja, bija e Bankës Botërore, i cili e përmirëson renditjen e Shqipërisë me 40 vende. Ky është një hov i thellë. Si e vlerësonte Banka e Shqipërisë brenda vendit, si e percepton publiku dhe biznesi gjendjen e ekonomisë dhe perspektivën, janë tregues të ndjeshmërisë ekonomike, ku edhe publiku dhe biznesi e vlerësojnë pozitivisht.

Natyrisht, merr vlera pozitive edhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura. Besoj se jam më i mirëkuptuar në këtë komision, sepse ka një debat jo shumë të hapur, por nën zë që “Po shlyejmë detyrime, pse po ia japim biznesit, kur mund të bënim investime!” E vërtetë është. Ne mund të bënim investime. Mund të kishim më shumë, në vend të 80 miliardë lekëve që kemi për vitin 2015, që është një shifër shumë më e lartë në krahasim me vitin 2014 dhe me vitet pararendëse, por ligjërisht ne kemi detyrimin për të shlyer detyrimet e prapambetura. Pak rëndësi ka që nuk janë të qeverisë sonë, por biznesi i ka dhënë qeverisë gjatë viteve të shkuara shërbime dhe punime të papaguara, ndoshta që fillojnë edhe 10 vjet më parë. Krejt natyrshëm, edhe pse ndoshta kontratat nuk janë precize që mund ta vinin qeverinë me

shpatulla pas murit, ne duhet t'i shlyejmë detyrimet ndaj biznesit, sepse në fund fare biznesi ato detyrime që merr i takojnë nga ana ligjore dhe do t'i çojë në investime dhe në punësim. Pra, po i vijmë në ndihmë ekonomisë dhe publikut për punësimin.

Shpenzimet për përmirësimin e shërbimeve ndaj publikut. Natyrisht që të gjitha investimet dhe paratë që shkojnë në buxhet kërkojnë një **rentë** më të sigurt, rezultatja e së cilës është një realitet sot dhe kërkojnë një shëndet më të përmirësuar. Nuk dua të shpejtoj me deklaratat e mia, sepse kjo është një e drejtë e Ministrisë së Shëndetësisë, por deri tani mund t'ju përmend faktin që çmimet e ilaçeve kanë filluar të bien, ashtu siç gjykohej. Pritshmëria është për një rënie edhe më të madhe, por le t'ia lëmë kohës dhe të jetë ministri i Shëndetësisë ai që do të flasë për këtë çështje.

Kërkojnë të kemi një arsim më cilësor, kuptohet më anë të reformës që do të bëhet atje; të kemi një shërbim më të mirë në tatim-dogana, sidomos në vitin 2015, kur të futet sistemi i ri i IT-së në tatim-dogana, sepse do të ketë një standard. Nuk është se jemi në kuadrin e mburrjeve të zakonshme, por duke qenë se Shqipëria ka hyrë në raste si “case study” për këtë çështje, do të jetë një eksperiencë edhe për rajonin, sepse Shqipëria u përzgjodh të jetë në rastet që Banka Botërore dhe FMN-ja kërkon të implementojë. Kështu që ky faktor do të japë rezultat, me praktika të reja, dhe do të jetë më modern. Kuptohet që flet për një buxhet, të cilit në vitin 2015 i janë dhënë relativisht shumë më tepër para edhe për sigurinë në rrugë, që është një çështje në dukje jo shumë e madhe. Ndoshta nuk vlen shuma e parave që japim në buxhet, por fakti që pritet të përmirësohet siguria në rrugë në mënyrë që humbja e jetëve njerëzore të jetë në ulje, sepse, siç e dimë, Shqipëria është e para në botë, në sensin negativ, për humbjen e jetës në rrugët e vendit.

Tabela që jep në mënyrë të përmbledhur buxhetin, në mënyrën më të përmbledhur të buxhetit është që totali i të ardhurave është 414,5 miliardë lekë. Totali i shpenzimeve është 475 miliardë lekë dhe investimet publike janë 5,4%. Për Shqipërinë është një nivel teknik – që të mos zbresë poshtë Prodhimit të Brendshëm Bruto. Jo vetëm që arri, po e tejkalon këtë objektiv. Deficiti është 60,5 miliardë lekë, ose 4% e GDP-së. Nëse më duhet të bëjë krahasim me vitin që jemi, është parashikuar diku te 6,6%. Kështu që është një përmirësim, që shkon në kahun që përmbledhet edhe me borxhin.

Si janë të ardhurat?

Në vitin 2014 shohim një rritje të ndjeshme të të ardhurave në krahasim me vitin 2013. Rritja që është vetëm në vitin 2014, që është vetëm e nivelit të të ardhurave, është më poshtë, por pothuajse baras me pesë vite të shkuara. Pra, bëhet një hop cilësor në vitin 2014 në nivelin e të ardhurave. Natyrisht janë një mori faktorësh që ndikojnë, ku brenda është edhe

përmirësimi në administratën fiskale shqiptare. Natyrisht që qëndron ideja që të ketë përmirësime edhe më tej. Është parashikuar që në vitin 2015 të kemi të tjera parashikime, po nëse do të na duhej të mblidhnim sa është rritja e të ardhurave në 6-7 vitet e qeverisjes së mëparshme, është më e vogël sesa rritja që do të vijë vetme në dy vite, në vitin 2014 dhe 2015. Pra, atë që realizon rritje të ardhurash vetëm viti 2014, që tashmë është pothuajse realitet, e kemi realizuar objektivin, dhe viti 2015, që është pritshmëria për realizëm, vetëm këto dy vite realizojnë më shumë se 6-7 vite të shkuara.

Grafiku jep që dy vite realizojnë 87,3 miliardë lekë më shumë nga 6-7 vitet e mëparshme, që realizonte 75,6%. Një tabelë tjetër, me një kënd vështrimi tjetër, për të mos marrë kritikën e deritanishme, që të mos shohim nga e kaluara, por të krahasohemi dhe me planin. E kemi realizuar dhe planin. Një tregues tjetër në shifra relative është edhe si shkon rritja ndaj GDP-së: shifra prej 27,8% ndaj GDP-së e nivelit të të ardhurave në Shqipëri, është niveli më i lartë i arritur në historinë e Shqipërisë. Kjo tregon një punë që është bërë nga organet fiskale, por që duhet shumë më tepër. Këto kurba të larta japin ku janë rritjet.

Le të marrim vitin 2008, ku rritja është 26,9% ndaj GDP-së. Vërtet është e lartë, por do të shikoni që rritja ekonomike atë vit ka qenë 7,5%. Ka qenë një rritje ekonomike shumë e fuqishme që doemos prodhonte dhe më shumë taksa. Për vitin 2015 rritja ekonomike është vetëm 3%, pra më pak se gjysma.

Lidhur me pjesën e shpenzimeve, ka një përshpejtim të reformave si në energji. Nëse reforma në energji do të marrë zhvillime edhe më të mira nga sa janë planet, kuptohet që do të lërë hapësira edhe më të mëdha për t'u rritur shpenzimet në ekonomi, që siç e shihni kanë trajektoren rritëse në dobi të ekonomisë.

Le të shohim dy-tre sektorë parësorë të ekonomisë: si shkojnë?

Ngjyra vjollcë natyrisht që është ngjyra e kësaj qeverie, por krahasimi nuk është i rregullt, sepse po flasim që vetëm buxheti i vitit 2015 e rrit arsimin më mbi 1,6 miliardë lekë, ndërsa në tre vitet e shkuara rritja është me 1,8. Pothuajse rritja është e njëjtë e një viti në krahasim me tre vite. Kështu është edhe për shëndetësinë. Kurse rendi ka marrë para shumë më tepër.

Ndoshta është me interes të themi se si shkojnë paratë për pushtetin lokal. Në vitet 2011-2013, që janë vite elektorale, rritjet janë me 30. Në vitin 2014 rritja është me 37. Pastaj kemi një hop me 41,2 miliardë lekë në vitin 2015. Pra kemi një rritje të fuqishme. Meqë është "historike" në relacion, por e përdor edhe këtu që është rritje historike.

(Diskutim pa mikrofon.)

Vlera historike lidhet edhe me historinë. Nëse ka arritur nivelin më të lartë në një periudhë kohë, të shtrirë, doemos ky është kuptimi i historikes. 41,2 miliardë lekë është sa dyfishi i mesatares së tetë viteve të shkuara. Doemos, pastaj fjala “historike” merr edhe një kuptim tjetër, sepse është vetë fakti që e imponon këtë. Nuk është relacioni që e tregon.

Të dalim te pjesa e paketës fiskale. Janë një sërë elementesh që preken nga paketa fiskale. Është komplekse. Ne themi që ka marrë për bazë raporte dhe rregullim raportesh në optimumin e vet, edhe në nevojat e buxhetit, por edhe në nevojat e biznesit, në mënyrë që të gjente atë konsolidim të buxhetit, por edhe përmirësim rrënjësor në marrëdhënie me biznesin, marrëdhënie që janë plotësua dukshëm gjatë vitit 2014 dhe shohin përmirësim dhe për vitin 2015. Për çështje ditësh, përveç paketës vjen edhe ligji i procedurave, i cili do të shohë edhe mendime të tjera të biznesit, por shoqëroi paketën, për arsye se donim të bënim edhe disa saktësime përfundimtare me biznesin, në lidhje këtë çështje edhe me ekspertë të fushave.

Çfarë prek kjo paketë fiskale?

Janë 14 masa kryesore. Në sekretin e tatimeve hiqet TVSH-ja, siç janë standardet europiane, por zbatohet një taksë prej 3% mbi primin bruto. Nuk është kompensuese në shumë, sepse buxheti humbet afërsisht 280 milionë lekë. Rëndësi ka që ne të shohim atë që presim nga biznesi i sigurimeve në Shqipëri, si shtirje të aktivitetit, ashtu dhe përmirësim cilësor.

Një tjetër element është rritja e rentës minerare për pushtetin vendor dhe heqja e kufizimeve nga buxheti. Do të shihni me grafik se grafika është edhe më e madhe se ajo që kam thënë deri tani, që pushtetit vendor në vitin 2015 do t'i jepet jo katërfishi i asaj që i është dhënë në vitet e mëparshme, por afër edhe afër pesëfishit. Jam munduar të jem korrekt me shifrën, duke marrë për bazë vitin 2014 dhe 2013. Realisht, në vitin 2015 do të japim katër herë më shumë. Kuptohet atyre pushteteve vendore që u përket renat minerare, sipas mineraleve.

Tjetër masë është për rafineritë e naftës në vend. Ulet taksa doganore naftës bruto, nga 10% në 0. Kjo masë merret për të nxitur prodhimin në vend të naftës bruto, për të kaluar në nënprodukte me vlerë të shtuar, por edhe më synimin për të rritur punësimin në vend. Kuptohet që jemi në favor të nxitjes së prodhimit dhe të përpunimit në vend të pasurive kombëtare. Janë tri industri që përfitojnë. Është industria minerare e naftës, industria e kromit dhe ajo e bujqësisë. Në mënyrë që të nxisim prodhimin në vend dhe të kemi vlerë të shtuar në vend, si dhe shtim të punësimit në vend, në dobi të individit a shtetasit shqiptar.

Një tjetër sektor është ai i përpunimit të mineraleve, pra ulja e rentës me 1/3 e saj për kromin përpunuar. Natyrisht në vitet që vijnë, ose dhe gjatë viti 2015, mund të shohim mundësinë edhe për industritë e tjera, gjithnjë brenda hapësirave që na lë buxheti,. Duhet të na mirëkuptoni që ka shumë kërkesa nga biznesi, por ne jemi munduar të gjejmë optimizmin dhe aq sa lejon buxheti.

Një tjetër masë janë gomat e reja: është ulur taksa doganore nga 15% në 10%, në mënyrë që të shtojmë sigurinë në rrugë.

Një tjetër industri është ajo e bitumit, bitumit natyral, së cilës i japim mundësi, duke i hequr akcizën, në mënyrë që të shtohet prodhimi i tij.

Tjetër fushë janë pensionet vullnetare, në fushën financiare. Shqipërisë i mungojnë për një mori faktorësh, por një nga shkaqet është se nuk kanë qenë të përjashtuara, ashtu siç janë, po e them pa frike, në botën e zhvilluar. Unë them që në tërësi, individët dhe kompanitë të nxiten që të krijojnë pensione suplementare, edhe për shkakun se pensionet shtetërore në të gjithë botën njihen si relativisht të pamjaftueshme për një jetesë normale, krijohen pensione suplementare ose ato që njihen si pensione vullnetare. Duke e hequr këtë taksë, do të nxiten më shumë individët dhe bizneset për të krijuar këto pensione vullnetare. Kuptohet që edhe ekonomisë i vihet në ndihmë, sepse sa më të zhvilluara të jenë pensionet vullnetare, të cilat zakonisht investojnë në instrumente afatgjatë, edhe borxhit shqiptar i rritet kohëzgjatja.

Një tjetër kërkesë shumëvjeçare e biznesit ka qenë njohja e firove, normativat e humbjeve gjatë prodhimit, magazinimit dhe transportit. Deri tani ka pasur një konflikt me të drejtë biznesi, por jo pa të drejtë edhe organet fiskale, që biznesi humbte, kishte firo në prodhim dhe në përpunim. Organet fiskale nuk e njihnin këtë gjë dhe e taksonin edhe për atë që ai humbte. Pse? Sepse nuk kishin normativë. Është vënë detyrimi që për 6 muaj qeveria të nxjerrë normativat e firove dhe organet fiskale kalojnë në një rrugë më miqësore për njohjen e këtyre firove. Do të shtohet fitimi i biznesit, por ai nuk është favor që ia bëjmë, por biznesi merr atë që i takon.

Një tjetër çështje në paketën fiskale është amortizimi në vlerën e mbetur. Deri tani ai nuk njihte fund në librat e kontabilitetit, por edhe në praktikën e biznesit. Tani është një ndërtesë që arrin 3% vlerën e vet dhe amortizohet automatikisht për çdo vlerë nën 3%, kurse për kompjuterë, IT, teknologji të avancuar deri në 10%. Kjo lehtëson dhe rrit fitimin e biznesit, por jep edhe mundësi për zhvillim e ekonomisë.

Në paketën fiskale është edhe çështja e rimbursimit të TVSH-së. Ajo sot rimbursohet pasi organet tatimore dhe doganore bëjnë kontroll në vend rast pas rasti. Do të kalohet mbi bazë risku. Bizneset që janë të klasifikuara si biznese të ndershme, do t'u hiqet

kontrolli dhe do të rimbursohen, ndërsa bizneset që vuajnë nga aspekti i ndershmërisë, do të kenë kontrole. Ky është kontrolli në bazë të riskut. Sa më riskoz të vlerësoshesh, aq më shumë kontrole ke, sa më pak riskoz, aq më pak kontrole, deri në zero.

Tatimi mbi të ardhurat personale, ku përveç tatimit për pagën, të cilën e kemi lënë me 97% e popullsisë përfiton e paprekur, siç kemi bërë tatimin progresiv, pjesa tjetër e të ardhurave personale barazohet në nivelin e tatimit me 15% nga 10%. Kjo masë është sa nxitëse për investime, për shembull marrim dividendin, nëse një individ pronar kompanie nuk e tërheq, dhe ne jemi të interesuar që ai të mos e tërheqë, por ta investojë, nuk merr taksë, në të kundërt merr taksë. Që ta nxisë të mos e tërheqë, ne kërkojmë ta ngacmojmë që ai të mos e tërheqë, por të investojë në mënyrë që të shtojë punësimin. Po kështu do të marrim taksën për interesat. Është e natyrshme që preket e gjithë popullsia nga rritja e kësaj takse, por ne kemi llogaritje të qarta nga ASD-ja që 1,9% e depozituesve kanë 41,1% të depozitave ose 4,3 e depozituesve kanë 69% depozita. Në mënyrë që t'i nxisim depozituesit, (më falni, se nuk jam i saktë në term, por do t'i quajmë biznesmenë ekzistues apo potencialë) që t'i marrim paratë dhe të mos i lënë në aktivitete pasive, siç janë depozitat në banka, por t'i hedhin në treg dhe t'i investojmë për të shtuar punësimin, kjo do të jetë një masë që ndikon.

Rritja me 10 lekë litri e taksës së qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin është një taksë sa ambientaliste, po aq dhe në mbështetje të sigurisë në rrugë. Ne kemi grafik të qartë sesi ka shkuar çmimi ndërkombëtar dhe ai i kësaj takse në Shqipëri. Kjo masë nuk është se ka pasoja siç komentohet dhe nëse do të ketë nevojë për sqarime, mund ta sqarojmë.

Është rritja e taksës së cigareve, që tashmë ka kaluar dhe e ka kapërcyer kohën dhe duhet të reflektohet në paketën fiskale, sepse ka të ardhura në paketën fiskale.

Lidhur me paketën fiskale, së fundi është mbështetja për bujqësinë. Një pjesë e deputetëve kanë ngritur shqetësimin për mbështetjen e gjysmës së popullsisë së vendit. Është një paketë tërësore e masave, por do të pasqyroj vetëm atë pjesë që i përket buxhetit të vitit 2015.

Së pari, do të përmend lehtësimin e agropërpunuesve duke u njohur 20% të TVSH-së. Deri më sot nëse një blerës i produkteve bujqësore midis importit dhe prodhimit të vendit do të synonte më shumë drejt importit, për arsye se rimbursohet me 20% TVSH, kur ti kishte prodhimin e vendit do të hezitonte, sepse do t'i duhej të plotësonte ose të hiqte nga fitimi i tij 14% të TVSH-së që i mbahej. Në këto kushte me këtë mënyrë e nxisim agropërpunuesin, por edhe blerësin me shumicë drejt mallit të vendit. Fermerëve shqiptarë u krijojmë më shumë mundësi për tregje në këtë drejtim, aq më tepër kuptohet që edhe publiku shqiptar merr çmime më të ulëta për prodhimet e vendit që janë me çmime më të ulëta. Ajo

që vlen për t'u thënë, është që sektori i bujqësisë merr një mbështetje shumë më të fuqishme si sektor prioritar me 27,6% rritje, ndryshe nga pjesa tjetër e ekonomisë, që mund të jetë diku në nivelet e 5%-shit.

Sektori i peshkimit, është vazhdimisht problematik. Për shumë vite është përpjekur të marrë naftën në vendet fqinje, pa akcizë dhe pa tatim qarkullimi, i është hequr dhe i është dhënë kjo mundësi. Presim atë që na është premtuar: shtim i kapjes së peshkut dhe ulje e çmimeve në tregun shqiptar.

Bëhet një përmirësim për lëndë të para për bujqësinë. Hiqet tarifa doganore për grurin, për miellin, për materialin biologjik, për ushqimin për kafshët dhe për kafshët në mbarështim. Kjo pjesa e parë e grurit dhe e miellit është në njëfarë kuptimi një presion për uljen e çmimit. Për pjesët e tjera si materiali biologjik ashtu edhe ushqimi për kafshët ose kafshët për mbarështim janë faktorë që do të nxisin edhe prodhimin bujqësor, blegtoral me tendenca të shtimit të konkurrencave dhe pritshmëri për ulje çmimi.

Ka qenë një problem i madh që prekte transportuesit që në dogana kur paraqiteshin, dilte që pesha e tyre ishte nën atë që kishin deklaruar dhe penalizoheshin. Tani njihet që pesha ulet në kohë, një ditë transport bagëtie apo të prodhimeve bujqësore, kuptohet që firon pak malli dhe këto firo pranohen nga organet doganore. Vlerat mund të ishin të mëdha, por penalitetet, marrëdhëniet biznes- organe tatimore prisheshin. Përfshihet nga tatimi mbi vlerën e shtuar importi i mjeteve dhe makinerive ushqimore dhe bujqësore, po kështu përfshihet TVSH-ja në importin e kafshëve të gjalla për majmëri.

Kjo ishte panorama tërësore. Nëse dëshironi, të dini më shumë për buxhetin vendor, mund të flas më shumë. Pra, kjo ishte pamja e përgjithshme e buxhetit dhe e paketës fiskale që e shoqëron atë. Për buxhetin vendor jo se nuk dhamë shifra. Ajo që shikohet është trendi i dukshëm rritës i buxhetit vendor. Shpenzimet për buxhetin vendor i jep më mirë grafiku, ku tregohet një rritje e qartë ndaj GDP-së, sesa peshë i është dhënë pushtetit vendor. Ka rritje të dukshme. Të ardhurat e pushtetit vendor, po marrin përsëri një kurbë rritëse. Kjo është një e mirë tjetër, sepse buxheti vendor, në një pjesë të mirë mbahet me të ardhurat që realizon vetë. Janë një sërë programesh që i japin zhvillim dhe investime në nivel lokal dhe rajonal, janë programe zhvillimore që në fund çojnë në buxhete të rritura. Ky grafik vetëm për të treguar diçka, nuk e kam me të gjithë seriozitetin e duhur, por meqenëse mora pak ngacmim, tregon se në këtë paraqitje të buxhetit, për herë të parë kemi përmbysje të raportit të shpenzimeve kapitale ndaj atyre korente. Nëse do të marrim vitin 2011, shpenzimet korente kanë qenë 26% dhe 74% : tre të katërtat janë shpenzime korente dhe një e katërta janë kapitale. Në projektbuxhetin e vitit 2015, janë 58% kapitale dhe vetëm 42% janë korente.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në vitin 2015 është raporti i përmbysur. Afër 60% shpenzime kapitale.

Lidhur me rentën minerare, të kalojmë te grafiku, të cilin ju premtova se do t'jua tregoj, në bazë të ligjit "Për rentën minerare", pushtetit vendor jetë e mot për aq kohë sa ka qenë ligji, se nuk është shumë i hershëm, i takonin 2 miliardë. Në buxhet gjithnjë i janë vënë më pak, i janë vënë 800 milionë. I është dhënë vetëm...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në fakt janë dy ligje. Nuk është dhënë asnjëherë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vazhdon shkelja në praktikë. I është dhënë një e dhjeta e asaj që i është premtuar. Siç ju premtova, kam thënë se do t'i jepen katër herë më shumë. Do t'i jepet mesatarisht pesë herë më shumë nga si është?

Shkëlqim Cani – Ligji ndryshon. Tashmë do të jepet ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mimoza Dhëmbi - Nga 25%, do të bëhet 5 %.

Shkëlqim Cani – Edhe këto tabela e japin. Shihni si është rritja e rentës minerare që i kalon pushtetit vendor dhe tabela e fundit apo e parafundit, është tabela që tregon se në cilat bashki shkon renta minerare. Me ligjin e ri, me ndarjen e re janë 25 njësi ose 41 % e bashkive që marrin rentën minerare dhe i keni me radhë, me emra se cilat bashki marrin rentën minerare, në zbatim të kërkesave ligjore. Nuk janë të prezantuara atje, por ne kemi dhe evidenca të veçanta, nëse do të keni interesin.

Faleminderit, zoti kryetar!

Ju falënderoj, të nderuar deputetë!

Ndoshta, isha shumë i detajuar, por buxheti është një ngjarje, siç thatë dhe ju, jo e shpeshtë dhe nuk ndikon vetëm një individ apo qeverinë, por ndikon mbi të gjithë ne si përfaqësues të popullit, dhe të gjithë publikun, kështu që m'u desh të sqaroj më në detaje disa elemente të saj.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër për ekspozenë shumë të qartë, të gjerë dhe konkrete që ju prezantuat lidhur me projekt-buxhetin dhe paketën fiskale!

Padyshim, ajo që është thelbësore dhe tipari dallues, është rritja e ndjeshme e buxhetit për vitin 2015, por natyrisht, si çdo buxhet ai ka rritjen dhe problematikat e veta për të cilat ka të drejtën si përfaqësues i popullit, secili nga deputetët, por për më shumë edhe

për fushën që ne mbulojmë si Komision i Ligjeve, të drejtojmë pyetje dhe të marrim përgjigje me shpjegimet përkatëse.

Zoti Fino, keni fjalën si relator i projektligjit!

Bashkim Fino - Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti ministër i Financave për ekspozenë shumë e gjatë politike dhe teknike që dhatë për projektbuxhetin, si një nga nismat më kryesore të qeverisë!

Unë jam relator për projektbuxhetin në tërësi dhe për ligjin e taksave kombëtare, ku bën pjesë renta minerare, jo për pjesën tjetër të paketës fiskale, sepse ajo kaloi në Komisionin e Ekonomisë dhe përsëri ju falënderojmë për sqarimet që dhatë edhe në komisionin tonë.

Zoti kryetar,

Nuk do të ndalem gjatë në relacionin prej 5 faqesh që kam paraqitur për anëtarët e nderuar të Komisionit të Ligjeve, sepse ata e kanë përpara, por për të përfituar në kohë, siç thatë dhe ju dhe mbase do të kemi fatin që të jetë ministri për të na kthyer përgjigje, mendoj se relacionin kolegët e kanë përpara dhe është një relacion korrekt mbi bazën kushtetuese të projektligjit të paraqitur, qoftë nga pikëpamja kushtetuese, qoftë nga pikëpamja procedurale. Ky projektligj është paraqitur në kohë dhe si relator jam i mendimit ta miratojmë në parim, por për të mos lexuar të gjithë relacionin, jam i mendimit që t'u japim mundësinë kolegëve deputetë të bëjnë pyetje dhe të marrin përgjigje për projekt-buxhetin dhe pastaj të bëjnë diskutimin në parim. Gjithsesi nëse ka ndonjë pyetje për relacionin, jam i hapur.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Kush ka pyetje?

Zoti Ndoka, keni fjalën!

Nard Ndoka – Ta fillojmë me opozitën.

Fatmir Xhafaj – Padyshim, opozita.

Nard Ndoka – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Ministër,

Ju ndoqa me shumë vëmendje gjatë detajimit teknik të projektbuxhetit. Ju keni parashikuar një rritje. Është e qartë që rritja vjen kryesisht nga rritja e taksave, pra, nuk është rritja ekonomike ajo që ndikon në përmirësimin e buxhetit.

Janë disa lloj taksash, por kryesore është rritja e taksës së karburanteve, e cila është taksë zinxhir, është taksë e ndjeshme dhe ndikon te çdo qytetar.

Cila është strategjia e qeverisë në këtë rast? Kjo taksë jetësore do të vazhdojë të rritet akoma më shumë me të papriturat që mund t'i dalin buxhetit tuaj edhe në të ardhmen? Kjo është pyetja e parë.

E dyta, ju paraqitet sot një buxhet, i cili është thjesht një buxhet teknik, por nuk shikoj diçka politike nga kjo maxhorancë dhe nga premtimet e saj. Pyetja është e drejtpërdrejtë: çfarë investimi kombëtar ka parashikuar qeveria nëpërmjet këtij buxheti? Kam parasysh investime të karakterit që ndikojnë në 2-3 qarqe apo më tepër se kaq, përveç disa investimeve lokale, nuk shikoj ndonjë strategji nga qeveria për investime kombëtare.

Pyetja e tretë është për shëndetësinë: keni premtuar një shëndetësi falas. Vërej që ka një rritje shumë të lehtë, madje, duke e krahasuar me rritjen e mëparshme, është e papërfillshme, pra, kjo tregon që ju nuk po e mbani premtimin për një shëndetësi falas dhe nuk po krijoni as mundësinë e përmirësimit të shërbimeve shëndetësore, duke e krahasuar me realitetin në të cilin ndodhet sistemi shëndetësor dhe me ato zhvillime që priten në të ardhmen. Nëse do të kishim shëndetësi falas, do të kishim një buxhet të paktën 3 herë më të madh se buxheti aktual. Pra, a duhet ta pranojmë që ky ishte një premtim elektorale dhe një tullumbace e shpuar tashmë, që edhe qytetarët të jenë të qartë për ato shërbime që do të vazhdojnë t'i paguajnë në mënyrë informate?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ndoka!

Zoti Ministër, mund t'u përgjigjeni 3 pyetjeve të kolegut tonë opozitar!

Shkëlqim Cani – Pyetja e parë ka të bëjë me strategjinë e qeverisë për taksën e qarkullimit, taksën e karburantit. Po, me ndërgjegje e kemi përfshirë këtë taksë në paketën fiskale, sepse siç e thashë, kjo është një taksë që njihet në të gjithë globin dhe për më tepër ne jemi në atë pjesë të globit, që është ndër flamurtaret apo ndër pararendëset e mbrojtjes së ambientit, kështu që ne duhet të ecim drejt atyre vendeve me të cilat aspirojmë të bashkohemi edhe ne dhe që po hedhim hapa në këtë drejtim. Në qoftë se taksa e qarkullimit dhe taksa në mbrojtje të ambientit njeh nivele të caktuara në të gjithë Europën, ne jemi ende jo në ato nivele, por duhet të shohim për rregullime dhe sisteme të nivelit të taksave në ato drejtime që shohin dhe vendet e tjera evropiane.

Ndërkohë, siç e parashtrova shkurt, doemos një element i dytë që na çon drejt kësaj takse, është siguria në rrugë. Në Shqipëri nuk kemi taksa të destinuara, por të gjitha taksat mbledhen në fund, futen në buxhet dhe doemos që përdoren për shpenzimet e buxhetit, por meqë kjo është një taksë më e lidhur drejtpërdrejt me sigurinë në rrugë, me rrugët etj., doemos, që në buxhetin e vitit 2015, kemi shtuar para për sigurinë në rrugë dhe kuptohet që

një nga drejtimet që do ta mbushin këtë, është kjo taksë. Natyrisht, që kjo taksë rëndon në ekonomi dhe natyrshëm çdo taksë edhe kur e thua si fjalë taksa zero, ka efekt negativ të ai që e dëgjon, sepse çdo taksë është rëndesë, por ekonomia e tregut rron dhe mbështetet mbi sistemin e taksave. Ne e provuam një regjim që ishte pa taksa dhe tani jemi te një regjim që natyrshëm, duhet të bazohet te disa taksa. Sipas gjykimit tonë kemi për zgjedhur ato taksa që njëherësh arrijnë objektivin e mbrojtjes së ambientit dhe sigurisë në rrugë, por rezultojnë edhe një e ardhur për buxhetin e shtetit.

Në xhepat e biznesit apo të individëve, kjo është një çështje për t'u debatuar (sipas gjykimit tonë dhe kur të na jepet koha e mjaftueshme), që të mos e zgjas shumë këtë përgjigje, ne do të dimë të argumentojmë se përse dhe si nuk ka pritshmëri për rëndesë ashtu siç po përfillet pa të drejtë, deri më sot dhe deri diku, kemi një eksperiencë edhe për këtë.

Lidhur me investimet kombëtare, të më fali zoti Ndoka, si përfaqësues i opozitës, por kuptohet që ka një ndarje midis qeverive. Bëhen zgjedhjet dhe vendoset nëse do të rrijë në fuqi një grupim politik apo një tjetër. Qartazi në 23 qershor u dha vota për një tjetër grupim politik, por në një kuptim tjetër, më të gjerë, Shqipëria qeveriset dhe pak rëndësi ka se cila është qeveria në fuqi. Qeveria aktuale s'mundet që ditën që vjen, të marrë kazmën dhe të prishë çdo gjë që është në vijim nga qeveria e shkuar apo aq më shumë, kur ajo është në dobi të vendit. Nëse bëhen llogaritje me ftohtësi, na binte që vetëm frontet e punës të hapura për t'u inauguruar vetëm për qëllime elektorale, ne s'i mbyllim dot. Domethënë, buxhetet e 4 vjetëve qeverisje do të na mbanin të lidhur me të gjitha ato objekte, që kanë harxhuar para të barabarta me 1-2 apo 3 shirita. Kështu ka qenë, në fillim bliheshin shiritat, fillonin inaugurimin në mes të punimeve dhe një pastaj po ta kishte fatin që të mbaronim punimet. Kështu që janë harxhuar këto para për shirita dhe në objektet që kanë filluar me shirita vetëm, doemos që do të harxhosh shumë para për t'i mbaruar, sepse aty ku ka filluar është vetëm 50%, qeveria është e detyruar ta çojë deri në fund këtë. Kështu që shumë nga punimet nuk po mbyllen. Nuk e di pse e përflet opozita e sotme qeverinë. Nuk po gjejmë dot, se nuk po gjejmë dot vetveten, se duhen mbyllur doemos disa punime që kanë të tilla elemente.

Por a ka të tjera projekte? Një projekt madhor, të cilin e përmenda, është ai i energjetikës. Është jashtëzakonisht i madh: 200 milionë dollarë do të shkojnë për energjinë. A nuk ju duket sektor kombëtar? A nuk duket çështje kombëtare? Në fakt, është më shumë se kaq.

Një tjetër projekt është për mirëmbajtjen e rrugëve. Një projekt tjetër është bujqësia që ju thashë, merr 26,6% më shumë. Pra, janë investime dyfish. Janë një sërë

projektesh, por, po të lexohen me vëmendje dhe me mirëdashje, opozita do të ishte mbështetëse e fuqishme e këtyre projekteve, siç po bën qeveria, në fakt me ato projekte, që janë të dobishme, të cilat po i vijon.

Për të mos u zgjatur, po kaloj te pyetja e tretë, që ka të bëjë me shëndetësinë.

Ka një rritje të lehtë, e rëndë, e lartë, e ulët; këto janë terma relative. Do të duhet t'i bëjmë krahasimet pak edhe me periudhat e mëparshme, por unë nuk do ta marr ashtu.

Ju keni qenë ministër i Shëndetësisë. Në tetë vjet kanë qenë një mori, aq sa është gjykuar, ministra shëndetësie. Unë jam i detyruar t'ju them se ne kemi një filozofi krejt tjetër. Filozofia është e përmbysur si nga ku synojmë “shërbim shëndetësor falas për të gjithë”, që është një filozofi krejt e re, por ndryshon edhe për këtë aspekt që ju kërkoni. Ne kemi filozofinë që me më pak para do t'i japim më shumë shërbime popullsisë. Nuk dua të deklaroj se si dhe sa, sepse jua thashë do të jetë ministri i Shëndetësisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ju lutem!

Shkëlqim Cani – Mirë, ju që e njihni...

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, mos hyni në replika!

Shkëlqim Cani – Ju falënderojmë për leksionin!

Fatmir Xhafaj – Edhe kolegët deputetë të mos bëjnë replika jashtë procedurës, edhe zoti ministër t'i evitojë!

Shkëlqim Cani – Do të shihni që ne do të ulim edhe 30% nivelin e shpenzimeve që do të shkojnë për qytetarin dhe do të rrisim 30% nivelin e shërbimit për qytetarin. Do ta shihni që filozofia “me më pak para, me më shumë shërbime” do të realizohet vërtet.

Në fund fare besoj se biem dakord që të gjithë: pozitë, opozitë, ekonomistë, juristë, edhe ata që janë jashtë këtij profesioni që një buxhet arrin suksesin jo të harxhojë shumë para, por të harxhojë pak para dhe të bëjë shumë shërbime edhe cilësore për shtetasit e vet dhe unë ju tregova disa nga drejtimet në parashtrësën që bëra dhe kuptohet në mbrojtje të filozofisë së qeverisë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Ka pyetje nga kolegët e tjerë?

Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Ministria e Financave do të na e falë edhe ndonjë sens ironie, sepse jemi ulur nga krahu i opozitës sot në komision dhe na nxit kjo si ide.

Unë do të dëshiroja të dija cili është niveli i pagesave që është bërë për vitin që po mbyllim për sa u përket borxheve, që janë lënë nga kontratat shtetërore, të cilat ne i kemi diskutuar jashtëzakonisht shumë kur miratuam buxhetin e vitit të kaluar? Shoh që edhe për këtë vit do të paguhet përsëri një shifër shumë e majme. Do t'ju lutesha të shpjegoheshit më qartë lidhur me këto masa restriktive karshi parave të taksapaguesve për të paguar borxhet, sepse, me sa shoh unë nga ajo që paraqitet dhe, ju lutem, më korrigjoni, kuptova që ne përsëri vazhdojmë me një buxhet restriktiv, i cili ka boshtin e pagesës së borxheve të vitit të kaluar dhe energjinë. Por edhe energjia përsëri është një krizë borxhesh. Sigurisht, e kuptoj që këtu ka një histori negociatash me FMN-në, që mendoj se duhet, dhe po kaloj te pyetja e dytë: cila është historia e negociatave në vazhdim me Fondin Monetar Ndërkombëtar për sa i përket buxhetit të këtij viti?

Kam një pyetje tjetër. Dje në Kuvend, dhe unë dëshiroj t'ju uroj edhe ju personalisht, përveç ministrit të Punës, kaluam ligjin e pensioneve të minatorëve.

Ju jeni deputet i një zone që ka shumë minatorë. Unë jam deputet i një zone elektorale këtu në Tiranë që ka shumë ish-ushtarakë dhe dëshiroj t'ju them se krahas përgëzimit që përfundimisht fondin e pensioneve të oficerëve e hoqët nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, sepse ishte komplet një artific për të thënë se “po rrisim buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes”, a ka ndonjë dritë jeshile? A ka ndonjë dritë në fund të tunelit në planet afatmesme të Ministrisë së Financave për çështjen e pensioneve të ish-ushtarakëve?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Majko!

Urdhëroni, zoti Ministër!

Shkëlqim Cani – Lidhur me pyetjen e parë, me nivelin e borxheve të vjetra, në buxhetin e vitit 2014 parashikimi është që të shlyhen 35 miliardë lekë borxhe të vjetra ose afërsisht 350 milionë dollarë.

Deri tani janë shlyer 25,9 miliardë lekë ose afërsisht 259 milionë dollarë. Kuptohet, në periudhën e mbetur do të shlyhet edhe pjesa e mbetur, prej afërsisht 9 miliardë lekësh. Për këtë pritet auditi ndërkombëtar, i cili ka filluar prej muajsh. Audit i ndërkombëtar do të duhet të japë një vlerësim të paanshëm se si janë shlyer këto detyrime. Pra, nëse qeveria i është përmbajtur programit të vet dhe a kanë shkuar paratë tek ata që u takonte dhe sipas parimeve që u takonte, që është sistemi FIFO, më i lashti, më i hershmi të shlyhet më përpara, të cilat kanë qenë transparente të shpallura në faqen online të Ministrisë së Financave për t'u verifikuar edhe nga biznesi.

Kuptohet, ashtu siç edhe ju thatë, se edhe në buxhetin e vitit 2015 është parashikuar një shumë relativisht e madhe, ju u shprehët “e majme”, që është 20 miliardë lekë ose 200 milionë dollarë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo, për ta thënë në terma relativë pranohet edhe “e majme”, edhe “shumë e madhe”, edhe “e madhe”, mund ta themi si të duam, por janë shumë para.

Filozofia është e thjeshtë, ajo që unë e shpreha në fillim, që me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me Bankën Botërore kemi rënë dakord që në fillim të marrëveshjes se do të shlyejmë 35 miliardë, 20 miliardë dhe pothuajse 16-17 miliardë në vitin 2016. Pra, ky është një akord që ne po vazhdojmë ta plotësojmë.

Së dyti, për të qenë më realistë dhe më konkretë, nuk kemi ku të shkojmë.

Në marrëdhëniet individuale, për shembull, Bashkim Finos i kam një borxh prej 1 milion lekësh. Tani është e pakuptimtë që unë të filloj të ndërtoj shtëpinë pa shlyer një detyrim shumëvjeçar ndaj zotit Fino. Po këto janë marrëdhëniet, madje edhe më parësore të shtetit me shtetasit e vet dhe me biznesin e vet. I ka marrë një shërbim dhjetë vjet më parë, dhunshëm nuk ia ka dhënë dhe për të qenë korrektë deri në fund me pak hile ose padije nga ana e biznesit, sepse kontrata nuk është krejt e qartë, ne nuk mund t’i themi “Ne jemi qeveri e re, nuk t’i japim”, siç edhe bënte qeveria e vjetër. Në fakt, jo që bënte, por unë kam qenë personalisht në bisedë televizive në kohën e opozitës ku përfaqësuesit të biznesit i thoshte: sa para ju kanë borxh ministrat? Nuk guxoi ta artikulonte: Më ka 100 lekë, 1000 lekë, 2 lekë, asnjë lekë”, por më thoshte: “Është shumë e komplikuar”. Ndërkohë, sot përfaqësuesit e biznesit kanë hyrë në të tilla marrëdhënie dhe uroj, dhe them të shtohen zërat kritikë ndaj administratës fiskale në rastin konkret për përmirësim, se sot na marrin shpirtin dhe për një gjë fare të vogël ngrihen në televizivet dallgë të mëdha.

Krejt natyrshëm, edhe një herë, nuk kam ndonjë gjë, por e kërkojnë jo borxhin që po e po, por edhe atë që nuk e kanë. Pse? Sepse është çështje që i kemi dhënë hapësirën, mundësinë, se kjo është demokracia, por ama e njohim edhe detyrimin dhe duhet ta respektojmë.

Jemi të ndërgjegjshëm, zoti Majko,

Jemi të përgjegjshëm, zoti Majko, që po të mos jepnim këtë 20 miliardësh, investimet nuk do të ishin 80 miliardë, që janë shumë më tepër nga 67 të këtij viti, por do të ishin 100 miliardë, do të ishin pra 1 miliard vetëm investime të drejtpërdrejta.

Ne e kemi zgjedhur këtë rrugë, ne kemi rënë dakord dhe prapë unë them me bindje se bëjmë mirë që i japim biznesit. Pse? Këto para në fakt biznesi nuk ka parimin t’i marrë, të

hapë një gropë dhe t'i zhysë diku ose t'i hedhë në humnerë ose t'i tresë në det, por do t'i çojë investime, do t'i çojë vende pune, përveç asaj që ia kemi detyrim për të mos ia falimentuar për t'i dhënë mundësinë, për t'i dhënë dorën se në fund biznesi është yni.

Ne themi se do ta realizojmë 3% rritjen ekonomike. Në fakt, do ta realizojë biznesi, por ne do t'i japim hapësirat, ne do ta ndihmojmë të mos e pengojnë. Ky është parimi dhe doemos që do të shkojnë shumë para.

Lidhur me historinë e negociatave me FMN-në për buxhetin e vitit 2015, nuk është më ndoshta për kohën dhe jo më që nuk është Shqipëria se zakonisht jemi mësuar ta themi për mburrje që nuk jemi më ne ata nxënësit, por nuk është edhe koha në botë që FMN-ja të hyjë në detaje, ne e kemi të rakorduar në njëfarë kuptimi, të konsultuar me FMN-në buxhetin e vitit 2015. Misioni vjen në datën 17 nëntor dhe kuptohet ne do të vazhdojmë negociatat, bisedimet, sqarimet, sepse është një konsulent, kjo sipas gjykimit personal, por dhe të qeverisë, sepse ne e ftuam. Ai na jep ndihmë për probleme të ndryshme që ne kemi pasur dhe kemi. A kemi dallime? Është e natyrshme dhe kjo. Unë nuk është se konsultohem me FMN-në sot si ministër i Financave, por dhe jam konsultuar dje si ish-guvernator, apo si ekspert i pavarur. Unë i kam marrëdhëniet e hershme, pothuajse 20-vjeçare me ta. Unë nuk e di në 20 vjet që ne, pavarësisht nga ana deklamative e iks opinionisti, ose e ndonjë përshtypjeje që krijohet, që Shqipëria ka bërë amin për çdo gjë që thuhej. Kuptohet kjo është veçoria, ne FMN-së i themi shumë për vendin tonë, për gjendjen për realitetin, për specifikat, ndërsa ata na thonë shumë për atë që është provuar në të gjithë globin, ku ata kanë eksperiencë dhe na thonë se ky rast është i provuar në 30 vende dhe ka dështuar. Kuptohet dhe ne e shohim më me konservatorizëm pastaj atë që kemi propozuar, në mënyrë që të gjejmë atë që i bëhet më mirë vendit, sepse dhe ne dhe ata nuk kemi ndonjë qëllim për të shkuar vendi keq. Kuptohet ka raste kur ata janë më agresivë se ne dhe kuptohet që ne jo të gjitha gjërat e tyre i pranojmë, për arsye se ne e shohim më ndryshe dhe kuptohet që duam të gjejmë optimumin. Marrëdhëniet tona janë normale, nuk shohim ndonjë faktor i cili duhet marrë në ndonjë kah jo e jo negativ, por as edhe neutral. Janë marrëdhënie të mira, normale, mes partnerësh.

Lidhur me ish-ushtarakët. Natyrisht që u bë një hap për një shtresë të shoqërisë. Kuptohet buxhetet janë me problemet e veta. Unë nëse thashë se buxheti është optimist, realist, ai duhet parë në progresivitet dhe duhet mbështetur. Është detyra jonë si deputetë qoftë pozita apo opozita që ta reklamojmë atë që është e mirë në një buxhet. Kuptohet buxheti ka elementet e veta. Ndoshta do t'ju vijë si shaka, por për rastësi kur isha në Berlin për shkëmbimin e informacionit lidhur me taksat në të gjithë globin, kjo është iniciativë e OECD-së e mbështetur nga të gjithë vendet ku ishte dhe Shqipëria, është firmëtare në ato që

quhen flamurtarë të firmës, pra më të avancuarit, atje takova ministrin e Financave të Norvegjisë. Për dijeni Norvegjia nuk është si ne, nuk diskuton që mineralet t'i marrë shpejt e shpejt si ne, t'u marrë të ardhurat, t'u gjejë menjëherë destinacionin, por një pjesë të pasurive nëntokësore ua lë edhe brezave të ardhshëm, se është pasuri për të gjithë brezat. Ne nuk e kemi këtë luks. Pra, është me një buxhet surplus në gjendje shumë të mirë. Unë e pyeta për buxhetin e tyre. Më tha se kishte shumë probleme. Pra, buxhetet gjithmonë do të kenë probleme. Buxhetet asnjëherë nuk i kënaqin dot të gjitha shtresat, të gjithë individët, të gjitha degët e ekonomisë, por hap pas hapi. Në rastin konkret këto plane, më saktë nga unë, i ka ministri i Mirëqenies Sociale, i cili në fakt tek unë duhet të gjejë “kundërshtimet”, për arsye se unë jam njeriu që përgjithësisht duhet të jem në këtë pozicion, sepse jam ministri i Financave. Kjo nuk është nga luksi, por as dhe nga e keqja, por në fakt ministri i financave është në atë pjesë që stigmatizohet më shumë nga të tjerët që duhet të shohë balancat në buxhet dhe ta frenojë në dëshira. Unë shpresoj që jo vetëm ish-ushtarakët, por dhe shtresat e tjera ta gjejnë veten në ato të drejta që ju takojnë.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka pyetje? Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër!

Unë kam një pyetje lidhur me shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Ju thoni në relacionin që shoqëron projektbuxhetin se pjesa e detyrimeve është ndaj bizneseve dhe kompanive të mëdha. A ka përlllogaritur institucioni juaj detyrimet që ka nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë në gjykatat shqiptare? Në relacion ju përmendni vendime gjyqësore, çështjet e pronësisë dhe parashikoni një buxhet prej 1,2 miliardë lekësh vetëm për vendimet e Gjykatës së Strasburgut. Ndërkohë, shumica e vendimeve të Gjykatës së Strasburgut është dhënë sepse nuk ekzekutohen vendimet e gjykatave shqiptare. Ne kemi disa vendime pilot vetëm për mosekzekutim të vendimeve të gjykatave të vendit.

Pra, doja të dija se sa është buxheti që keni parashikuar për ekzekutime të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të gjykatave shqiptare, që të mos shkojnë dhe të marrin një faturë të majme në Gjykatën e Strasburgut?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Po, zoti Ministër.

Shkëlqim Cani – Le t'i ndajmë në dy çështje problematikat. Ka detyrime të prapambetura, ka dhe detyrime që potencialisht krijohen nga vendime gjykatash. Ka dhe një

ndarje tjetër, Strasburgu dhe gjykatat shqiptare. Unë ju mirëkuptoj në të gjitha këto që thatë dhe e kuptoj që Strasburgu nuk është gjë tjetër veçse preludi i të gjithë atyre që kanë ndodhur në vend, pastaj atë të japin shuplakën e fundit që të tregojnë se duhet të tregohemi korrektë me shtresat e shoqërisë, me biznesin, me këdo si të jetë rasti i gjyqeve. Specifike është vënë në buxhet 1.2 miliardë lekë për një vendim tashmë të marrë të Gjykatës së Strasburgut për 8 milionë euro. Familja Karagjozi, pak rëndësi ka. Kjo është për këtë.

Lidhur me vendimet gjyqësore në Shqipëri, çështjet e vendimeve gjyqësore të prapambetura, ne me sistemin Fifo kam ndjekur parimin që më të hershmit të shlyhen më përpara. Ne kemi bërë shlyerje dhe me vendime gjykate. Pra, unë nuk e di shumë tani saktësisht se sa është, por janë shlyer edhe ato institucione që kanë pasur detyrime ndaj tyre prej vitesh për largimin nga puna, për vendime gjykatash të formës së prerë. Ndërsa për ato raste të reja dhe ka dhe të tjera që do të jenë në vazhdim te shuma 20 miliardë lekë që do të shlyhen, jo vetëm në biznes, biznesi përmendet se ai zë volumin e madh, jo se nuk përmenden këto që kanë një volum relativisht të vogël janë në buxhetet e çdo ministrie. Natyrshëm që janë në buxhete shumë të kufizuara, në mënyrë që ministrinë të bëjnë kujdesin e duhur, jo t'i çojnë njerëzit gjyqeve pothuajse të fituara, por të bëjnë kujdesin që të largojnë nga puna apo të japin drejtësi në vendimet që ato marrin brenda ligjeve, në mënyrë gjyqet të fitohen.

Lidhur me Strasburgun është ngritur një grup pune, ku dhe unë jam pjesëtar, si përfaqësues i Ministrisë së Financave, për ta riparë në tërësi këtë çështje, për të mos e lënë, por nuk është në ato reformat strukturore për t'u përmendur, si energjia, pensionet, por edhe kjo në mënyrë që të marrë rrugë. Unë nuk jam jurist, por e kuptoj Gjykatën e Strasburgut që kërkon zbatimin e ligjeve në vend. Në qoftë se me ligj ne duam t'i themi do të paguajmë tregun a përmbi tregun, natyrshëm që ato do të marrin vendim që t'i hapësh tregun. Në qoftë se me vendim ti thua që këto janë mundësitë e buxhetit dhe ne do të shlyejmë brenda këtyre hapësirave, natyrshëm që dhe ata do të rregullojnë sjelljen. Kështu që grupi përbëhet nga juristë, ekonomistë, disa ministri për të gjetur hapësirat lidhur edhe me këtë çështje. Kur të marrim kohën, vëmendjen dhe zgjidhjen e duhur, ose ata që janë si më kryesorët, Ministria e Drejtësisë, ndoshta japin detajet e duhura. Sot për sot ne po mundohemi që të mos jetë vetëm punë e shqiptarëve, kemi kërkuar dhe ekspertizë, që quhet ekspertizë ndërkombëtare secili sipas përkatësisë nga institucionet. Ministria e Financave me Bankën Botërore e FMN-në, por pa lënë pas dore organizmat e KE-së, BE-së etj, jemi në bashkërendim dhe me ministrinë e tjera.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Fino, për të mbyllur pyetjet.

Bashkim Fino - Faleminderit!

Unë e falënderoj dhe një herë ministrin për lodhjen e tij që pati sot me ekspozenë që bëri. Kam përshtypjen se do ta lodh dhe unë me disa pyetje që kanë të bëjnë më tepër jo për të gjetur defekte, siç e thatë dhe ju çdo buxhet nuk zgjidh çdo gjë brenda një viti, por për të rregulluar më mirë dhe për të përmirësuar gjërat. Meqenëse jam dhe në cilësinë e relatorit më duhet të marr një përgjigje nga ju. Keni dhe kohën e nevojshme derisa ta kalojmë dhe nen për nen, apo dhe kur ta kalojmë në parim, që të mund të bëjmë ndonjë ndryshim të mundshëm të projektbuxhetit.

Zoti Ministër, është e vërtetë se është bërë një ndryshim shumë i madh në grantin e pushtetit vendor. Pra, nga 33,1 miliardë që kanë qenë vitin e kaluar, në vitin aktual shkon 41,2 miliardë lekë, dhe që është buxheti vendor. Si është autonomia financiare? Pra, për çfarë shume pushteti vendor vendos për destinacionin nga kjo 41,2 miliardë lekë?

Unë, zoti Ministër, e di përgjigjen. Unë e bëj më tepër për kolegët e mi, por dhe për publikun, se 41,2 miliardë ndahen si më poshtë:

12,4 është transferta e pakushtëzuar.

12,2 janë fondet e rajoneve.

13,5 janë taksat dhe tarifat nga pushteti vendor që i realizon vetë.

0.4 është renta minerare, siç e thatë dhe ju. Tarifat e pushtetit vendor janë 2,6 Madsje nga transferta e pakushtëzuar në një aneks 1 që ju jeni munduar t'i trajtoni gjërat mirë, por që një sy i vëmendshëm mund ta kapë, keni hequr dhe 1,2 miliardë lekë të tjera, që do të thotë se transferta e pakushtëzuar arrin në 11,2 miliardë lekë.

Pra, në vlerë absolute, zoti Ministër, në qoftë se transferta e pakushtëzuar, si transfertë e pakufizuar, në vitin 2014 ka qenë 13,3 miliardë lekë, sot për 2015-n na rezulton 11,2 miliardë lekë. Pse? Kjo është pyetja e parë. Unë njihem si një njeri që historikisht kur kam qenë në opozitë, por edhe tani, një vit e ca që jam në pushtet, kam bërë pyetje gjithmonë në funksion të decentralizimit të pushtetit vendor dhe jam për këtë.

Pyetja e dytë që kam është përsëri politike dhe e dua nga ju politikisht, jo nga ata që keni në krah. Për buxhetin që merr vendime pushteti qendror, pse raportoni si buxhet i pushtetit vendor? E kam fjalën për 12,2 miliardë lekë, fondin e rajoneve. Natyrisht, shkojnë në komunitet, jam shumë i kënaqur edhe me investimet që po bëhen sot në shumë qendra të qyteteve, por vendimmarrja nuk është e pushtetit vendor, por e pushtetit qendror. Natyrisht,

e kam politike, e kam kritikuar ish-kryeministrin Berisha për këtë gjë, po ju kritikoj në mënyrë shumë publike dhe shumë dashamirëse edhe ju, për këtë çështje.

Pyetja tjetër. Siç e dini, e gjithë pjesa e buxhetit varet nga GDP-ja dhe më lejoni të them se ajo pjesë e buxhetit për pushtetin lokal, është rritur pak, nga 2,4 ka shkuar në 2,8 të GDP-së. Më duhet t'ju vlerësoj dhe t'ju them faleminderit për aq sa na e keni rritur, nga 2,4 në 2,8. Megjithatë, unë dua të di nga ju apo nga ministri për Çështjet Vendore, a ka ndonjë politikë apo strategji që të kemi një diferencë midis vendeve të rajonit për GDP-n dhe të kemi sa më shumë lekë për pushtetin vendor në funksion të GDP-së, siç e kanë sot vendet e rajonit?

Pra, edhe këtë rritje që ju keni bërë, është shumë e vogël në raport me vendet e rajonit dhe strategjia që duhet të kemi është si do të jetë në vitet e ardhshme?

Zoti Ministër, ju e dini që kam qenë kryetar i komisionit dhe e përmend si një nga reformat e mëdha reforma territoriale dhe në atë reformë territoriale që e kemi miratuar dhe besoj se duam ta implementojmë vitin që vjen, që janë edhe zgjedhjet lokale, kemi thënë me forcë edhe unë, edhe një nga ministrat e qeverisë suaj që do të kursehen mjaft fonde. Madje rreth 60 milionë dollarë në vit, nga ndryshimi strukturor që ne do t'i bëjmë pushtetit vendor, pra, nga rreth 400 njësi vendore 383, në mos gaboj, do të jenë 61 bashki.

Pyetja që kam është: Paratë që vitin që vjen nuk do ta kenë efektin 100%, por do ta kenë iks për qind, për sa muaj do të jenë? Sa kursyem nga kjo reformë territoriale? Në çfarë mënyre do të kalojnë në favor të pushtetit vendor? Sepse, në fund të fundit, nuk është ministria juaj apo buxheti juaj keq për 60 milionë dollarë, por ato duhet të kalojnë për pushtetin vendor, mendoj unë.

Zoti Ministër, e kam thënë dhe po e them përsëri. Neni 15 është neni më famëkeq, më i poshtër, në të gjitha bilancet dhe buxhetet, që kanë ardhur në Shqipëri. Vazhdon të jetë përsëri neni 15 edhe në projektbuxhetin e 2015-ës dhe më lejoni të them se mund ta pranoj me dhimbje edhe këtë radhë, zoti Ministër. E dini pse e pranoj? Po ta them si sugjerim, po të doni ktheni përgjigje, po të doni mos ktheni, sepse jam shumë i bindur që me reformën territoriale që ne bëmë nuk do të ketë më besoj nen 15 për projektbuxhetin e vitit 2016. E dini pse nuk do të ketë? Sepse në qoftë se ju vini klauzola që për bashkitë deri në 20 mijë banorë, 20% është transferta që përdorin për pagat, për bashkitë nga 20 mijë deri në 50 mijë përdorin 15% e kështu me radhë, mendoj se 61 bashkitë do t'i kenë kapacitetet e nevojshme do të jenë personalitete që të mos i vëmë klauzola të tilla në buxhetet e ardhshme për të treguar sa para do të harxhojmë për paga sa do të harxhojnë për komunitetin.

Zoti Ministër, unë jam dakord me një paragraf që keni bërë te neni 15, por nuk e kuptoj si do t'i jepni zgjidhje? Ta kuptojnë edhe kolegët e mi se ndoshta nuk e kanë lexuar. Është një paragraf te neni 15, ku thua: “këshillat e qarqeve përdorin vetëm 15% të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ”. E dini çdo të thotë kjo, zoti koleg? Në projektbuxhetin e vitit të kaluar ka qenë 55% e transfertës së pakushtëzuar. Çfarë dua të them me këtë? Dua të them që një kryetar qarku, me ligjin që është në fuqi, me 55% që do të merrte nga granti i pakushtëzuar, mbante në punë afërsisht rreth 70 punonjës. Me këtë që ju keni shkruar këtu dhe që do të ngrenë dorën këta dhe, pa dashur të fyej asnjë, mund të mos e kuptojnë se çfarë është ky 15%, i thua sot qarkut që do të mbash jo më shumë se 10 vetë në punë, jo 70. Do të thotë që shkurtohen 60 të tjerë. Shumë mirë.

Edhe unë e kuptoj që në kuadrin e një reforme duhen shkurtuar njerëzit nga puna. Po problemi që kam është se sot këta njerëz janë nëpunës civilë? Do të ketë efekte përsëri buxheti për këta që lirohen nga detyra, për shkak të dy vjetëve që do të marrin pagat e kështu me radhë?

Vazhdojmë më tej. Zoti Ministër, e kam lexuar buxhetin me kujdes dhe kam shumë sugjerime për disa nga anekset e këtij projektbuxheti. Anekset janë shumë të rëndësishme. Ne i kalojmë anekset, por në anekse ka shuma dhe fonde, të cilat miratohen dhe nesër qeveria thotë që i kam kaluar në aneksin kaq.

Pyetjet e aneksit numër një. Unë kam diskutuar dhe kam qenë kundër formulës së famshme të ndarjes së grantit të pakushtëzuar dhe të transfertës së pakushtëzuar. Mbaj mend që vitin e kaluar na është thënë edhe në grupin tonë parlamentar kemi bërë debat, sepse jemi një grup shumë liberal, që bëjmë debate të hapura dhe shumë nga kolegët e mi e mbajnë mend, por edhe këtu në parlament, kemi thënë që kjo formulë që është zbatuar nuk do të zbatohet më. Pra, ne do ta korrigjojmë formulën. Shikoj që formula nuk është korrigjuar. Ka mbetur ajo që është. Më duket se edhe kjo formulë do të ketë fatin e keq të nenit 15, mendoj unë edhe në qoftë se nuk keni mundësi për ta ndryshuar dot më, sepse nuk do të ketë më efektivitet kjo lloj formule pas reformës territoriale që ne bëjmë. Në fakt, nuk e keni mbajtur fjalën, sepse duhet të ndryshohet. Për shkak të kësaj po u them kolegëve të mi, që janë deputetë në zonat e tyre, sot transferta e pakushtëzuar për njësitë vendore është më e ulët nga viti 2014.

Për vitin 2015 çdo komunë dhe bashki merr më pak për shkak të kësaj formule të gabuar që ne kemi. Kjo është pyetja që kam për pikën 1.

E dyta në këtë formulë dhe në këtë aneks, zoti Ministër, jam çuditur me thënë të drejtën, kjo është një shpikje juaja dhe unë ju falënderoj se ju jeni edhe novator dhe ju lumtë,

si e keni gjetur, sepse të heqësh 1,2 miliardë lekë nga granti i pakushtëzuar, kuptohet që po e hoqe, do t'ia japësh një sektori tjetër, mund t'ia japësh shëndetësisë, transportit, arsimit, sportit, kujt do, por ju keni menduar pushtetin lokal dhe keni thënë jo, nuk e jap, por do ta ruaj këtë për reformën administrative territoriale.

Mua më duket një artificë kjo këtu. Është kot. Pra, është një xhep i ruajtur, ku ti thua, unë do ta ruaj këta 1,2 miliardë lekë dhe kur të bëhet reforma e zgjedhjeve në vitin e kaluar unë ministri i Financave do ta shpërndaj sipas bashkive që mund të më interesoj.

Kjo ka dy gabime të mëdha, për mendimin tim, dhe duhet korrigjuar urgjentisht:

1. 1,2- miliardëshi nuk duhet të jetë në aneksin 1, por duhet të ndahet brenda grantit të pakushtëzuar.

2. Nëse ndahet brenda grantit të pakushtëzuar, nuk do ta keni fatin e madh që ta ndani ju vitin tjetër, por edhe sikur të jetë kështu, ju vetë duhet të jeni korrekt, duhet të thoni se duhet ta ndajë qeveria dhe jo ju personalisht, sepse të të votoj unë, të jap në dorë 1,2 miliardë për t'u ndarë bashkive dhe ty nesër të bësh, më fal nuk të paragjykoj, po them sikur jam unë ministri i financave të bëj ndere se kujt dua t'ia jap 1,2 miliardë lekë mua më duket jokorrekte. Më duket jokorrekte pika 8 e aneksit 1 ku thuhet fond për zbatimin e reformës së re administrativo- territoriale.

Vazhdojmë më poshtë. Zoti Ministër, te aneksi 3 kam një sugjerim. Keni bërë një aneks të ri është fat i madh për fondet e zhvillimit të rajonit. Pyetja që kam unë është pak ironike, më ktheni përgjigje edhe ju po deshët ironike por deshët edhe politike. Shpërndarja e financimit dhe menaxhimit të fondit të zhvillimit të rajoneve drejtohet nga Kryeministri dhe në përbërjen e komitetit janë: zëvendëskryeministri, ministri i Financave, ministri i Ekonomisë, ministri i Turizmit, ministri i Transportit, ministri i Arsimit, ministri i Bujqësisë, ministri i Shëndetësisë, ministri i Kulturës, ministri i Mjedisit, ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Shtetit për Inovacion dhe ministri për Pushtetin Vendor. Janë 13 ministra dhe një Kryeministër, shkojnë 14. Domethënë është komplet qeveria, por janë edhe kryetari i shoqatës së bashkive, edhe kryetari i shoqatës së komunave, edhe kryetari i shoqatës së qarqeve që janë dy- tre vota minore.

Pyetja ime është: A kanë pasur ndonjë rol shoqatat dhe bashkitë në ndarjen e këtyre fondeve të rajoneve? Pra, le të themi në qoftë se këta kryetarë shoqatash kanë thënë ky fond do të shkojë në filan qytet, këta 13 ministrat në rresht e kanë ngritur dorën për të thënë dakord le të shkojë ky fond atje?

Prandaj, zoti Ministër, do të flas edhe në diskutimin në parim që jam në parim kundër fondit të rajoneve, sepse janë fondet e pushteti vendor që ndahen nga qeveria. Këtë

ka bërë edhe qeveria e kaluar, këtë mund të bëjmë edhe ne vitin që vjen, mund ta bëjmë, për shkak të reformës territoriale, por mendoj se në 2016 duhet fshirë përfundimisht një gjë të tillë, sepse është jashtë konceptit tim për decentralizimin. Mund ta kalojnë kolegët e mi, ta votojnë, do t'i bindem shumicës, por nuk e pranoj dot një gjë të tillë.

Vazhdojmë zoti ministër me pyetjet. Po bëj edhe komentet që ta kuptoni edhe ju më mirë.

Më falni, zoti kryetar ju jeni edhe jurist, ju respektoj, po ju them një gjë, dua mbështetjen tuaj në kuptimin juridik. Aneksi numër 6 është një katastrofë e vërtetë. Aneksin numër 6 për mua në këtë projektbuxhet asnjë nuk e lexon, por po ta lexojë, për mua nuk qëndron, zoti Ministër.

Cili është efekti i aneksit numër 6? Unë, në radhë të parë, dua t'ju falënderoj që keni marrë iniciativën për të bërë një aneks 6 në formën e një udhëzimi për të trajtuar dhe për të na thënë ne se çfarë do të ndodhë në momentin që bëhen zgjedhjet lokale në qershor apo në shtator të vitit që vjen, dhe çfarë do të ndodhë pas saj për ndarjen e buxhetit për 61 bashkitë. Me pak fjalë ky është aneksi 6.

Po ta marrësh ta shikosh dhe ta lexosh aneksin 6, unë e kam lexuar me kujdes, e kam nënvizuar, pasi jam edhe njohës i pushtetit lokal, të falënderoj për çfarë ke bërë, sepse mund edhe të mos e bëje fare, mund të thoshe vetëm një fjali, transferta e pakushtëzuar për bashkitë dhe komunat ndahet në muaj në 3-mujor. Dhe ti e ndaje në muaj 3- mujor, jepje çdo muaj në moment, në qershor bëheshin zgjedhjet lokale i thoshe stop bashkisë së re, sepse me vendim qeverie, shuma është në buxhet, do të bëjë një rindarje të re nga 384 njësi me 61 bashki. Kaq mbaroje. Për mua një fjali duhet të bëhet.

Pse nuk duhet bërë kjo? Pyetja që kam është: Çfarë kostoje del nga aneksi 6? Që nuk më ktheni dot përgjigje ju, jo se nuk dini, por sepse e kuptoni që nuk duhet vënë këtu. Çfarë rreziqesh kanë në normalitetin e njësive të qeverisjes vendore nëse do t'i vihet kjo? Aneksi 6, a është një masë centralizuese dhe nuk duhet të ndikonte në uljen e përgjegjshmërisë të pushtetit lokal? Dhe do të jetë, sepse ju thoni këtu që drejton prefekti dhe zyrat tuaja të thesarit. Pa vënë firmën ata nuk përdor asnjë lekë pushteti lokal. Kështu thoni ju në aneksin 6.

Cila është zgjidhja? Po, ka një zgjidhje shumë racionale. Ka një ministër shteti për pushtetin vendor, i cili bëri një reformë bashkë me ne, për ndarjen territoriale-administrative. Dhe ai ministër shteti e ka për detyrë të implementojë ligjin 115 të vitit 2014, pra, 115/2014 është ndarja territoriale- administrative në Shqipëri dhe e ka për detyrë ky ministër ta implementojë ligjin. Implementimi i ligjit është shumë herë më i vështirë, zoti Ministër, ju e

dini shumë mirë, sesa vetë ligji që ne bëmë për ndarjen territoriale. Çfarë kuptimi ka që të mos ngremë ne një grup pune nga çdo ministri nën drejtimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të ngremë 8 deri në 10 instruktorë pranë Ministrit të Shtetit për të implementuar ligjin e reformës territoriale? Çfarë do të thotë? Nuk është vetëm thjesht çështje parash, ka të bëjë me inventarët, me pasuritë, sepse një bashki e madhe është si shumatore e disa komunave e bashkive sot, pra do të fillojë që nga pasuritë, inventarët, nga fondet e kështu me radhë.

Për sa u përket kontratave, siç thatë edhe ju, një komunë mund të ketë një kontratë me një firmë të caktuar, që ka bërë pastrimin e komunës dhe mund të ketë detyrime, të cilat duhet t'i zgjidhë, ndërsa bashkia e majtë që do ta marrë do të bëjë një kontratë tjetër, e kështu me radhë. Shiko se çfarë thoni ju te kjo pjesë që jeni munduar të jepni një zgjidhje, por nuk i keni dhënë dot zgjidhje: “Pasi organet e qeverisjes vendore do të dalin nga zgjedhjet e vitit 2015 të jenë të konstituuar dhe në mbledhjen e parë duhet të diskutohet buxheti dhe problemet financiare.” Po ta them unë që nuk bëhet dot kaq shpejt. Mbledhja e këshillit të bashkisë së re të madhe nuk mund ta bëjë menjëherë mbledhjen për buxhetin. Mbledhja e re e bashkisë së madhe, flas gjithmonë e bashkisë së madhe.

Gjithashtu thoni: “drejtuesit e njësive vendore suprimohen nga ndarja territoriale, duhet të përgatitin inventarin” e të tjera me të radhë. Shumë mirë e thua ti, por a do të ketë një afat se kur do ta bëjnë inventarin? Këtu nuk ka asnjë afat, ndaj them që kjo është një formë udhëzimi, që mund të bëhen me vendime qeverie. Pra, ky grup pune me në krye ministrin e Pushtetit Vendor mund të bëjë vendime të njëpasnjëshme qeverie mbas zgjedhjeve lokale, të jenë ekzekutive të veprueshme nga prefekti dhe nga zyrat e thesarit tuaj e të veprohet dhe të kontrollohet nga ky ministër.

Çfarë thoni tjetër këtu? “Në dorëzimin e detyrave”, sepse është në kompleksitet kjo që nuk ka zbatim, “drejtuesit e ish-bashkive dhe komunave që suprimohen, janë të detyruar të asistojnë në një periudhë 1-mujore strukturat e njësive të reja vendore.” Pse? Pse ia thua ti në buxhetin e shtetit? S’dua të rri unë.

Më falni, se po flas pak me pasion, sepse është një çështje që e njoh shumë mirë. Për të zbatuar ligjin e ndarjes territoriale, nuk mund të veprohet me një Aneks 6, sipas mendimit tim. Duhet ta konsultoni, zoti kryetar, e kam edhe për ju, me kryetarin e Komisionit të Ekonomisë dhe me ministrin e Pushtetit Vendor, sepse është një çështje që duhet konsultuar dhe duhet zgjidhur.

Armando e di shumë mirë, sepse ne kemi qenë në komision dhe gjithë problemin e kemi pasur sesi do të implementohet ligji, por nuk implementohet me këtë. Në qoftë se do të

implementohet me këtë aneks, më lejoni, zoti kryetar, unë kam shumë vërejtje për Aneksin 6, që duhet korrigjuar e duhet bërë shumë herë më i mirë.

Po për shumë probleme që mund të na dalin, zoti Ministër, në praktikë mbas zgjedhjeve lokale si do t'i bëjmë, në qoftë se nuk i vëmë tek Aneksi 6? Do të bëjmë përsëri një ligj tjetër?

Më mirë është që të drejtohet një grup pune nga Ministri i Shtetit dhe i bëjnë këto me vendim qeverie, bëhen veprimet, sepse po t'i bëjmë në ligj, ngelet këtu dhe pastaj gjërat atje nuk i bëjmë dot. Kjo ishte për çështjen 6.

Vazhdojmë më tej duke ardhur te krahasimet. Dy shembuj dua të jap për krahasimet, nuk dua të ndërsej asnjë nga kolegët e mi deputetë, por më lejoni t'ju them që buxheti dhe transferta e pakushtëzuar, minimalisht në qoftë se komuna apo bashkia Maliq kishte 22 milionë lekë transfertë të pakushtëzuar, po e hamendësoj, për vitin 2014, a duhet të ketë 22 500 milionë lekë në vitin 2015, qoftë edhe 500 më shumë lekë? Duhet të ketë.

Po ta krahasosh, zoti Ministër, dhe unë e kam krahasuar edhe me të vjetshmin, se jam i rregullt dhe i mbaj gjërat, edhe me këtë që ju na keni detajuar transfertën e pakushtëzuar për bashkitë e të gjitha me radhë, më rezulton: përjashto që jeni treguar në njëfarë mënyre edhe servil me kryetarin e opozitës, dhe mirë keni bërë, i keni lënë të njëjtën shumë dhe e keni mbajtur mirë me atë Lul Bashën, kurse kryetarët e bashkive së partisë sime, por edhe tëndes, fatkeqësisht, kanë një diferencë në grantin e pakushtëzuar nga viti 2014 me vitin 2015. Dëshironi t'ju them disa shembuj? Po ju them disa shembuj: Durrësi në vitin 2014 e ka pasur 437.906, sot ju propozoni 428. Elbasani në vitin 2014 që jemi sot e ka 370.370 dhe ju propozimi që të marrë 340 nga 370, prapë me ulje. Vazhdojmë më tej, zoti Ministër, meqë më kërkuat disa shembuj, Maliqi e ka pasur 26,2 grantin për këtë vit, ju i propozoni që të marrë 23,9 për vitin që vjen, pra më pak.

Më fal, zoti kryetar, po dua të them disa shifra, sepse e meriton që të bëjë edhe korrigjimet e nevojshme. Lushnja që është e partisë sime, 132,8 e ka sot grantin, ju i propozoni që të marrë 124 për vitin që vjen dhe kjo është një diferencë e madhe. Divjaka e kishte 50 miliardë lekë sivjet, ju propozoni të marrë 45 miliardë për vitin që vjen. Po marr edhe nga veriu, Rrësheni e kishte 70,5 grantin për këtë vit dhe ju propozoni të marrë 66,7 për vitin që vjen. Rubiku e kishte 39,9 dhe ju propozoni të marrë 29,5 këtë vit që vjen. Pogradeci, dhe kjo është më e bukura, 81,9 e ka sivjet, ndërkohë që Pogradeci këtu e ka pasur 80,8. Po të marrim disa komuna të tjera si Udenishti e shumë të tjera janë skandaloze, kanë pasur 18, 19 apo 20 miliardë lekë, ia shpie në 13, 15, pra gjithmonë ka një ulje.

Do të vazhdoj edhe me dy shembuj për t'i bërë qejfin mikut tim, Dash Peza. Po të marr komunën Dajt, 35, 4 e kishte grantin për këtë vit, kurse vitin që vjen ti i thua merr 25,8 se boll e ke. Vaqarri e kishte 19,7 dhe ti i thua merr 14, Peza e kishte 21,5, ti i thua merr 15,3. Ndroqi e kishte 16,5, ti i thua merr 12,1, pra kam plot shembuj të tjerë, por nuk do të vazhdoj më. Unë prandaj të them që të bësh zgjidhjen. Zgjidhjen mund t'ia gjesht ti, mund t'ia gjej edhe unë, sepse kam disa shifra këtu dhe mund të them merre këtë 1,2 shpërndarje dhe vete prapë diçka më shumë se ç'kishte, por e bëra sepse shumë nga kolegët e mi nuk bëjnë pyetje dhe bëjnë mirë që nuk bëjnë pyetje.

Vazhdojmë te relacioni ku kam një pyetje tjetër.

Zoti Ministër, unë kam qenë tip shkollastiku shumë për numrin e punonjësve të shtetit dhe kam qenë në një linjë me ju dhe fatkeqësia jonë e di cila ka qenë? Moza ka qenë drejtore e buxhetit në atë kohë, atëherë, atëherë, atëherë, sot dhe do të vijë dhe do të jetë po prapë dhe, kur është diskutuar ndonjëherë numri i punonjësve, gjithmonë kam qenë në krah të Ministrisë së Financave, pavarësisht se mund të kem qenë edhe në opozitë.

Zoti Ministër, numrin e punonjësve sot në të gjithë Shqipërinë, sipas grafikut që na keni dhënë ju, e keni 87.700 veta, por, në fakt, e ke të gabuar, sepse duhet të kesh më shumë. Numri i punonjësve vitin e kaluar ka qenë 86.100 veta. Tani të lutem, zoti Ministër, si mund të ketë një diferencë kaq të madhe prej 1 600 vetash dhe sot më ka ardhur një evidencë po prapë nga ju ku më thuhet që numri i punonjësve për vitin 2015 do të jetë 88.772 veta dhe 86.100 ka qenë vitin e kaluar? Pra, 88.772 po të heqësh 86.100 i bie rreth 2.672 punonjës që shtohen sivjet në buxhetin e shtetit.

E dini pse po e them, nuk kam ndonjë merak se po shtoni punonjësit, e para një herë vetë ju duhet të jeni të interesuar të mos shtoni, por, kur të na vijnë këtu institucionet tona si Avokati i Popullit, i cili kërkon 1 shtesë dhe Moza këtu bën namin, në asnjë mënyrë, s'kemi mundësi, me këto shifra që po të them këtu, unë dhe po të duash, zoti Ministër, po të jap edhe ministrinë ku janë shtuar, ka ministri që janë shtuar, ka ministri që janë ulur, duke filluar nga Kryeministria duke vazhduar te Ministria e Ekonomisë që shtohen 30 veta, Ministria e Transportit që shtohen, Ministria e Financave që shton 35 persona, nuk e di pse i shton, po ne ngremë dorën dhe do t'i shtojmë 35 veta, sepse i shton, ti e di. Ministria e Sporteve ku thuhet se do të kemi 700 arsimtarë dhe 50 për sportin, por në fakt këtu na del minus 646 në krahasim me vitin e kaluar. Ministria e Drejtësisë që shton 419 veta dhe mund t'i çosh nëpër burgje dhe shumë mirë që shton atje, Ministria e Mirëqenies shton 1.413 veta. Nuk më intereson fare, unë po them shumën, ti ma argumento më poshtë.

Vazhdojmë zoti Ministër, Ministria e Integrimit shton 13 veta. I kam këtu përpara. Prokuroria e Përgjithshme shton 13 veta, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor 30 veta, po marr edhe institucionet që kemi ne këtu, të themi edhe gjënë e mirë. Gjykata Kushtetuese 1 vetë, Shkolla e Magjistraturës 1 vetë, Komisioni për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 3 veta, Ministria e Energjetikës 13 veta, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit 134 veta. Pra, janë gjithmonë shtesa e numrit të punonjësve në raport me vitin që jemi në vazhdim, pra i bie rreth 2.672 veta që shtohen për vitin tjetër.

Unë mendoj që këtë duhet ta rakordoni edhe një herë, bashkë me Komisionin e Ekonomisë, duhet ta rakordoni me rigorozitet, mendoj unë dhe ne duhet të jemi të vetëdijshëm të shtojmë atje ku duhet shtuar, por ama duhet pasur parasysh edhe tjetra, që duhet pakësuar atje ku duhet pakësuar. Sa mirë që ju u bini me top organeve të pushtetit vendor, dhe mirë bëni, unë dakord jam, që qarqet janë një nivel i dytë që nuk bëjnë asnjë lloj pune dhe s'mund të ketë 70-80 veta që të rrinë kot si parazitë. Po mos punoni me dy standarde? Në qoftë se disa i shkurtoni në mënyrë drastike, disa të tjera nuk mund t'i shtoni, por mund të bëni përzierjen brenda për brenda institucioneve.

Kisha një pyetje, sepse i kam bërë sipas faqeve dhe relacioneve që ju keni bërë këtu, pyetje edhe që zoti Majko përmendi këtu për borxhet dhe ju e sqaruat shumë mirë, por kam një sugjerim. Ju në relacionet tuaja, zoti Ministër, e keni shumë të detajuar, e keni shumë të mirë relacionin dhe unë them që, në qoftë se ky relacion do të adoptohej në shifra, do të ishte buxheti më i mirë historik që ka Shqipëria.

Në faqen 16 të relacionit ju thoni që “reformat e decentralizimit fiskal do të përqendrohen në saktësimin e marrëdhënieve fiskale midis pushtetit qendror dhe atij vendor. Kjo do të realizohet nëpërmjet hartimit dhe mirëmbajtjes dhe ligjit “Financa vendore”. Kur do të bëhet kjo, zoti Ministër? Kjo është teori, në qoftë se ma thua në relacion, ma thuaj kur do të bëhet, sepse, në qoftë se do të bëhet ligji i financave vendore, unë nuk do të bëj më vërejtje, pyetje dhe këtë diskutim, sepse i saktëson ajo përfundimisht dhe jam i qetë shpirtërisht.

Mos u konsulto tani, mund të marrësh dhe kohë për të më dhënë përgjigje, se mund të jenë edhe pyetje të vështira, mund të jetë relacion, por i thua politikisht ti, por se kur bëhet, jam i bindur që nuk mund ta dish.

Marrim faqen 22 të relacionit, se i kam lexuar të gjitha, në fakt dua që edhe publiku të kënaqet, por dua vërtet që në fund të vitit tjetër unë do të bëj një interpelancë me ju personalisht që e keni vënë këtë në relacion, nuk kam punë me Englantina Gjermanin në qoftë se do të jetë ajo atje për këtë punë.

Shiko se çfarë thotë relacioni këtu për ujësjellës-kanalizimet, që mua më intereson, por i intereson edhe gjithë publikut shqiptar, më pëlqen jashtëzakonisht relacioni që keni bërë këtu. “Zgjerimi, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve me furnizim me ujë të pijshëm ndërmjet mbulimit dhe rrjetit ujësjellës në zonat urbane do të arrijë në masën 95% dhe në zonat rurale 79%, flasim për buxhetin që vjen.

Pra, furnizimin me ujë të pijshëm, të dashur qytetarë, qeveria ime do ta realizojë 95% në qytete dhe 70 % në fshatra në fund të vitit 2015.

Vazhdojmë më tej, vazhdimësia e shërbimit të furnizimit me ujë në shkallë vendi do të jetë 16 orë në ditë, nga 58 ndërmarrje do të kemi 53 ndërmarrje të ujësjellësve. Po të duash, mund të vazhdojmë më tej, me kanalizimet që thuhet se kanalizimet në zonat urbane do të realizohen 86%, dhe në zonat rurale 25%.

Cila është pyetja ime, zoti Ministër, më dëgjoni pak ju lutem. Pyetja ime është se unë jam shumë entuziast, ju keni një ambicie të paparë në këtë relaciori për ujësjellës-kanalizimet, më vjen mirë, mua më duhet të them se kjo që shkruani këtu në relaciori është fantastike.

Problemi që unë kam me ju dhe me qytetarët është një gjë tjetër. E mbani mend, zoti Ministër, apo nuk keni qenë në parlament ju, kur erdhi Sali Berisha në pushtet tha: “Zotërinj të Kuvendit, vitin e parë të pushtetit tim unë do t’i jap 24 orë ujë të gjithë bregdetit shqiptar, dhe turizmi nuk do të vuajë për ujë. Mbas një viti i kam kërkuar interpelancë, ku i thashë: “Zoti Kryeministër, na the se do të kemi ujë 24 orë para një viti, dhe në të gjithë bregdetin shqiptar nuk kishte ujë 24 orë”.

Zoti Ministër, ose korrigjojeni këto shifra që vini këtu ose të jeni të ndërgjegjshëm me qytetarin shqiptar që dhe atyre t’u themi vërtet që 95 % në të gjitha zonat urbane do të ketë ujë për shqiptarët të cilët, do të kenë nga 24 orë do të ketë 16 orë ujë në ditë. Kjo është një çështje që njerëzit duhet ta dinë dhe ne kemi kohë deri më 27 nëntor ta korrigjojmë, nëse i kemi mundësitë. I kemi mundësitë financiare? Hajde ta bëjmë dhe ta trumbetojmë që kjo është qeveria që po bën reformën territoriale, reformën në energji, reformën në ujë e kështu me radhë.

Prandaj, në mbyllje, zoti kryetar, unë të gjitha pyetjet që kisha i bëra në formë komenti për t’i dhënë mundësinë edhe ministrit, edhe stafit të Ministrisë së Financave sepse nuk dua përgjigje të thjeshtë, pyetje përgjigje, por të reflektojmë nëse ne mund të reflektojmë disa nga këto ndryshime që unë thashë. Nëse më thonë sot se unë e kam ndarë mirë grantin, se është në rregull, se është rritje, historike dhe historike është, se nga 33, 1 miliardë në 41 është historike rritje e pushtetit vendor, atëherë unë do të mbetem shumë i zhgënjyer dhe do të më

duhet të jap dorëheqjen si relator, pastaj se më duhet të bëj amendamente për ndryshimin e disa pikave kryesore.

Prandaj, mendoj se është që më mirë të reflektojmë sesa të bëjmë diskutime. Është në nderin tuaj të jepni mendimet tuaja.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Fino!

Bashkim Fino – Për ligjin e taksave kombëtare, kam tri pyetje. Në këtë pikë më keni dëgjuar se e kam kërkuar prej kohësh. Duhet ta dinë të gjithë kolegët e mi se çfarë është renta minerare. Renta minerare? Në ligjin e mëparshëm 25 % e rentës minerare i kalonte pushtetit vendor, që e tha edhe ministri, që shkon te 2 miliardë lekë të rinj që e merr automatikisht pushteti vendor pa pyetur asnjë ministër Financash, asnjë Kryeministër. Ç’ka ndodhur gjatë kohës që ka qenë në pushtet e djathta? Kanë marrë çfarë kanë dashur, edhe gjëra të vogla, qindarka, por edhe këtë vit zoti Cani ka dhënë 100 milionë apo 200 milionë nga renta minerare, por në fakt duhet të jepte 2 miliardë. Ajo që ka bërë zoti Cani këtë radhë, që të mos shkelim ligjin më, hajde ta ulim, mos të marrin 25 % organet e pushtetit vendor, por të marrin 5%. Nga llogaritja në atë 5 % na del që shkon jo më shumë se 400 milionë. Tani unë do të thosha se është pak 5%, por mbase ju e keni gjykuar të jetë 5% e cila në vlerë absolute shkon në 400 milionë.

Një vërejtje kam për nenin, më duhet t’ju them që fjalinë e dytë të germa “b” ku thuhet: “Fjalja e fundit ndryshon me këtë përmbajtje: “5 % të të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria.” Këtë fjali “të ardhurat minerare përdoren për investime në njësitë e qeverisjes vendore” unë mendoj se duhet ta hiqni se kjo është shkelje e të drejtave të kryetarëve të bashkive dhe të decentralizimit. Ose jepja, ose mos ia jep fare. Po t’i thuash ti që unë të jap 400 milionë, të cilat do t’i kalosh patjetër në investime më duket jo normale sepse në momentin që ti të gjithë këtë projektbuxhet me nenin 15 i ke vënë klauzola dhe i ke thënë që kaq për qind do të përdorësh për pagat, kjo e ardhur që do të shkojë aty, absolutisht ose do të shkojë për shërbimet, ose për gjelbërim, ose për investimeve. Ndërkohë që ti vë klauzolën që do ta përdorësh vetëm për investime, mua më duket jo normale. Pse e them këtë? Aq më tepër që bashkitë e reja që do të krijohen i kanë kapacitetet nevojshme që të mos bëjnë i kanë kapacitetet e nevojshme që të mos bëjnë gabime dhe nuk kanë mundësi ta përdorin 400 milionëshin për paga, sepse e keni vënë te neni 15 se sa për qind do të përdorë për pagat dhe kjo është një e ardhur shtesë plus.

Zoti Ministër, së fundi ju nuk do të fusni më duart te renta minerare, dhe më thatë me tabelë atje që janë 20 -25 njësi vendore dhe i bie që nesër të jenë 6-7 me ndarjen e re.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Kam dyshimet e mia, do ta verifikoj, se nuk e besoj se do të jenë 25 me ndarjen e re, por unë do të desha që të krijojmë një raport të përbashkët. A ka problem financimi i kësaj rente minerare? Për mua ka problem, se ti vërtet ia jep se ke mundësi, po zonat e tjera që nuk kanë mundësi të kenë miniera, siç dhatë shembullin ju, që ministri norvegjez mundohet t'i lërë pasuritë nëntokësore për brezat që do të vijnë, ndërkohë që ne po i shfrytëzojmë akoma me shpejtësi. Po për zonat e tjera që nuk kanë miniera si mund të bëhet një shpërndarje, pra do të ketë balancë ky grant i pakushtëzuar me këtë? Nëse Bulqiza do të marrë grantin e pakushtëzuar, do të marrë edhe këtë 400 milionëshin nga renta, atëherë me të drejtë Durrësi thotë po unë kam portin e Durrësit, pse nuk më jepni nga taksat portale? Dhe nuk i jep gjë, se i merr shteti. Dikush tjetër thotë, dale se është ndërtuar një hidrocentral këtu, merr energji e gjithë Shqipëria, në Kukës, të marr pak energji unë? Pra, pse po e them këtë? Duhet të kemi kujdes me balancën e ndarjes së kësaj rente minerare me njësitë e organeve të pushtetit vendor që nuk përfitojnë nga renta minerare.

Ky ishte komenti dhe mendoj që neni i taksës kombëtare të kalojë, por me sugjerimin tim që kjo fjalë e fundit duhet hequr.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Ministër, unë mendoj që ta ndajmë në dy pjesë: së pari një përgjigje tuajën, pastaj, nëse ka nevojë për të reflektuar në detaje gjatë shqyrtimit nen për nen, do të duhet që ministria t'i sqarojë më konkretisht shqetësimet dhe sugjerimet e kolegut Fino, që është edhe relatori i komisionit.

Po, zoti Ministër.

Shkëlqim Cani – Së pari, jo thjesht me etikë që jemi mësuar të flasim me njëri-tjetrit ose duhet ta kemi të paktën, më duhet ta falënderoj për të gjithë këtë hulumtim në thellësi të të gjithë asaj që ne kemi bërë. Natyrshëm unë me modesti e thashë dhe e them se nuk është që doemos buxheti e ka arritur optimumin, ndoshta ka nevojë për rregullime, por ne e quajmë që ky është optimumi. Por, po të thosha këtë, natyrshëm që nuk do të lija hapësirë për të tjerët për të thënë fjalën e tyre. Natyrisht që ka hapësira për të diskutuar, por ne gëzojmë që më shumë mund të jenë çështje interpretimi ose sqarimi, sesa janë çështje që në

thelbin e tyre kanë prishur ndonjë raport apo nuk e kanë gjetur të mirën e duhur, ose më keq akoma, të kenë prishur gjë në buxhet.

Po e filloj me çështjen e fundit, që është e lidhur me rentën minerare që e marrin 25 bashki, flasim pas riorganizimit këtë 25, ose 41% e totalit, pra afro gjysma e përfitojnë dhe tani si do të bëhet me pjesën tjetër?

Faleminderit, zoti Fino, për presionin pozitiv që keni bërë që renta minerare të jepet 4-fish dhe besoj se edhe ju do të më falënderoni që unë e dëgjova dhe e mora parasysh presionin tuaj pozitiv dhe u dhamë atë që i takon atyre, se nuk është që ne bëmë ndonjë çudi.

Pyetja është se si do të bëhet me të tjerët? Për këtë është buxheti lokal, buxhet i cili është i rregulluar deri tani, ka nevojë të rregullohet më pas. Reforma kur të bëhet natyrshëm që do të sjellë probleme në sipërfaqet të cilat ne kemi kujtuar se i kemi i rregulluar, siç do të merremi me aneksin 6 supozojmë, ne me tonën kemi kujtuar se i kemi rregulluar, për dijeni edhe në bashkërendim edhe me ministrin e Pushtetit Lokal, por natyrshëm ju që keni dije për këtë çështje mund të gjejmë një zgjidhje tjetër që është edhe më e mirë.

Lidhur edhe me çështjen e investimeve, të dyja së bashku kanë një përgjigje, në fakt, renta minerare jepet, sepse edhe prishin investime, edhe prishin mjedise, edhe prishin atë pasuri që e ka zona. Pra, ajo pasuri nëntokësore kur del mbi tokë, nafta supozojmë, ndot me aromën, ndot me përbërësit që ka.

Pra, popullsia kryesisht në aspektin e investimeve goditet, dhe kryesisht duhet të marrë investime për një shtet normal, që t'i rikthehet shëndeti dhe mirëqenia, jo vetëm si para, por edhe mirëqenia totale për lumturinë, për t'iu rikthyer ato dhembët të jenë të bardhë dhe jo të nxirë nga nafta, ai i mineralit të kromit që i janë prerë pemë sepse do të hapej galeria dhe do të hidheshin mbeturinat që e kanë prishur ambientin. Për shembull, meqë po flasim për gjëra më konkrete në Bulqizë, për shembull, është krijuar një kënetë artificiale nga zënia që ka në atë pellg hedhja e mbeturinave etj., dhe kuptohet, këto janë para që në këto dhjetë vjet duhet të ishin hedhur atje, që të ishte hapur ai kanali dhe krejt natyrshëm të mos kishte as mushkonja, as edhe infeksione etj., që i vuan në fund të fundit popullsia. Prandaj, edhe këto marrin para më shumë nga të tjerët, si në gjithë botën, por nuk po flasim për sasinë, por të paktën si synim është, sepse është në të gjithë botën, dhe që duhet të shkojnë për investime për arsye se siç folëm deri tani që Ministria e Financave, por në fakt qeveria dhe Parlamenti, sepse Parlamenti është ballafaquar me të dy ligjet, i ka pranuar që të jepen më pak, por po kështu mund të spekulohet dhe të mos shkojnë për investime, por të shkojnë në drejtime të ndryshme, por duhet të shkojnë për investime, sipas gjykimit tonë.

Për të dalë përtej ligjit, lidhur me ujin. Natyrisht, zoti Fino, ju nuk e besoj të keni, qoftë edhe sikur për mua përshtypja të jetë shumë e mirë ndonjë iluzion që unë jam njohës edhe i ujit, edhe i energjisë, edhe i gjithçkaje, dhe për më tepër, që relacioni i buxhetit sheh nga e gjithë qeveria. Ministria e Financave nuk është gjë tjetër, veçse prezantuesja e atij ansambli, ose po të doni po u jap një kënaqësi punonjësve të Ministrisë së Financave, violinë e parë, por në gjithë orkestrën që luhet, se nuk e luan Ministria e Financave, dhe në rastin konkret është Ministria e Transporteve dhe e Industrisë ajo që i ka ujërat, por për dijeninë tuaj, investimet në ujë janë një nga gjashtë prioritetet e qeverisë dhe investimet janë rritur 50 % për vitin 2015. Pra, ka një hop cilësor në investimet për ujin që, doemos, ata që janë ekspertë të kësaj pune e kanë përkthyer edhe në 16 orë ujë, edhe në 90%, edhe që kaq ujësjellës, se nuk i kujtoj dot tani shifrat, por mund ta gjej në relacion, siç po e lexoja në atë kohë që ju mendonit që nuk po ju ndiqja, por në fakt doja t'ju ndiqja saktësisht, kështu që të gjitha janë përkthyer në shifra që sot për sot unë nuk kam asnjë të drejtë, as morale, as etike, që t'i vë në dyshim, që si të gjithë, si unë dhe kolegët e mi do t'i realizojmë ato që vendosim.

Kuptohet, që çdo tërheqje vëmendjeje për mua është një sinjal, është një shënim, që kur të kthehem në zyrë, të konsultohem me ministrin e Transporteve që me shaka sot i thashë edhe i ujit, për arsye se me palën zvicerane, pra në emër të qeverisë, me ambasadorin zviceran ne firmosëm një marrëveshje granti për 11,6 milionë euro, e cila do të shkojë në shtatë bashkitë e vendit për përmirësimin gjithnjë të çështjes së ujit. Kështu që, në këtë kuptim, unë sot për sot mbaj qëndrimin, pa e vënë fare në dyshim që ne do të shkojmë drejt këtij realizimi, kuptohet, pa ju thënë, ose duke e theksuar që mbajta shënimin e duhur për të konsultuar edhe një herë me kolegun tim mjaft serioz në këto çështje, zotin Haxhinasto.

Lidhur me pyetjen e 11-të, duke hequr ato tre të ligjit përkatës, ligjit të financave vendore, po, ka një strategji për këtë çështje. Unë për të qenë preciz me ju, përsëri do të duhet ta verifikoj, por kam idenë që strategjia është që në vitin 2016 për t'u bërë dhe është një strategji së bashku me Bankën Botërore për këto çështje, kështu që ne doemos duhet ta bëjmë këtë ligj, se unë ju mirëkuptoj që e doni sa më shpejt, por nuk është se na nxituar, për të qenë realist dhe korrekt me ju, por dhe ne në vetvete duam ta bëjmë një ligj të tillë, në mënyrë që të marrë ngjyrimin dhe trajtimin e duhur pushteti lokal lidhur me këtë çështje, dhe duke iu përgjigjur ndoshta edhe një pyetjeje më lart, që edhe na vlerësoni pozitivisht për atë që ne nga një nivel i caktuar në 2,2, kemi shkuar në 2,78 lidhur me çështjet e buxhetit lokal. Po, ne kemi në programin tonë afatmesëm dhe afatgjatë që të shkojmë, të paktën unë po them nga aspekti i ekspertëve që janë edhe më agresivë, që po, do t'i arrijmë vendet e rajonit dhe ne duam edhe t'i kapërcejmë, t'i japim pushtetit lokal atë që i takon. Ne biem dakord, zoti

Fino, me ju që pushteti lokal duhet të marrë pavarësi të plotë në të gjitha drejtimet dhe natyrisht, dhe pavarësia financiare është një nga elementet më thelbësore të pavarësisë, por të gjitha gjërat janë në një programim afatmesëm që gjykojmë që ta realizojmë, natyrisht, unë them të gjithë bashkë, sepse buxheti në fund është i qeverisë, por është edhe i Kuvendit.

Lidhur me çështjen dhjetë, numrin e punonjësve që janë shtuar, ju përmendët drejtimet ku ka rritje të punonjësve, natyrshëm të administratës publike. Duhet ta dini që po ballafaqoheni në këtë rast me ministrinë, ndoshta “më të poshtër” në këtë drejtim, sepse jemi ne gjithnjë që jemi pengesë për rritjen e numrit të punonjësve, por kuptohet që administrata është dinamike. Në fillimet e veta qeveria vendosi kritere etj., por kryesisht këta janë ekspertë ose më shumë ekspertë terreni në mënyrë që t’u japim përgjigje disa nga objektivat madhore që ne kemi vendosur për të reformuar jo vetëm administratën, por dhe në tërësi ekonominë shqiptare, kuptohet që është INUK-u që shtohet afërsisht, nuk jam i saktë në shifra, por besoj te 120 punonjës, sepse duhet t’i japim mbështetje në mënyrë që ndërtimet pa leje, informaliteti në ndërtime, të marrë fund njëherë e mirë, dhe kuptohet kjo mund të jetë një lëvizje që shtrihet në një vit apo në dy, apo dhe më gjerë, në varësi nga ecuria, por ama biem dakord të gjithë që lind nevoja edhe për numër njerëzish, edhe për t’u shtrirë në të gjithë Shqipërinë, jo vetëm në disa nga qytetet kryesore, por njëherë e mirë shqiptarët të mësojnë që ndërtimet të bëhen me leje, aty ku duhet, ashtu siç duhet, sipas planeve urbanistike etj.

Po kështu janë shtuar rreth 1100 policë në shërbim të rendit, në mbrojtje të rendit dhe të sigurisë së jetës të shqiptarëve dhe të biznesit shqiptar etj. Janë shtuar 750 mësues kryesisht të edukimit fizik, për të pasur një brez të ri të kalitur për shëndetin e vet, jo për qeverinë; janë shtuar afërsisht 400-480 policë burgjesh, sepse hapen tre burgje të reja në Berat, Fier dhe në një tjetër, nuk jam i qartë, do të më falni, se këto janë më tepër për debatet që kemi pasur, ne nuk i pranonim, pastaj natyrshëm që do t’i bëjmë, sepse kemi presione për të shkuar drejt administratave dhe drejt edhe burgjeve evropiane, si kudo, pastaj duhet të jenë diku te 43 punonjës që rriten për çështje të integritetit.

Shqipëria kaloi edhe një etapë tjetër, kështu që do të na duhet që në çdo ministri dhe në Ministrinë e Integritetit të rrisim numrin e njerëzve për projektet dhe të gjitha shumat që siç jepen grante konkurruese për pushtetin lokal, janë grante konkurruese ku Shqipëria nëse nuk ka njerëzit e duhur në çdo ministri dhe në Ministrinë e Integritetit për këtë çështje, natyrisht që nuk do t’i fitojë dot këto grante dhe ne nuk do të jemi tjetër, veçse do të jemi ata që ishim, që kemi fituar shumë pak nga këto fonde të BE-së, dhe për më keq akoma, kur ecim drejt anëtarësimit, ne të mos ndjekim shembullin negativ, por të bëhemi nga sa na thuhet, si Gjermania apo Austria, si më tipike dhe më afër nesh, si vend i vogël, që arrin të thithë

fonde, pra është një vend shumë i zhvilluar, dhe megjithatë arrin të thithë vetë fonde nga grantet konkurruese.

Lidhur me pyetjen nëntë, që lidhet kryesisht me formulën, e kuptojmë dhe me zotin Fino nuk është e para herë që ballafaqohemi, dhe unë, natyrisht, nuk kam si e fsheh, që po, ne kemi biseduar lidhur me këtë çështje, por formula e sharë, e përfolur, e vlerësuar është një formulë që ka vite që funksionon, një formulë, e cila është bërë me mbështetje të ekspertizës së USAID-it, është një formulë, e cila për t'u ribërë, unë nuk mund ta jap përgjigjen a duhet apo nuk duhet, siç e dhatë ju prerë, por e pranoj dhe logjikën tuaj, por le të shohim me kohë, është një formulë, e cila për t'u zëvendësuar, përsëri gjykoj që do të kërkojë mbështetje nga organizma ndërkombëtare, të specializuara edhe për të shmangur atë që do të quhet pastaj një kritikë pozitive-opozitive.

Unë i mbajta shënim të gjitha kritikën tuaj dhe të nënkuptuara edhe nga deputetët e tjerë të pozitës në rastin konkret, jam i sigurtë që Ministria e Financave me këtë çështje të pushtetit lokal nuk ka fitim, sepse opozita do të na turret edhe më keq ndoshta, dhe do të gjejnë edhe ata bashki dhe komuna që do t'ju duket se ne, me pa të drejtë duhet të kemi goditur...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në fakt formula ka kritere dhe ne kemi zbatuar kriteret. Unë nga ju do të kërkoja që secili të zbatojë formulën vetë dhe në qoftë se brenda formulës gjen të meta, kjo është një çështje tjetër dhe jemi të hapur për korrigjimin. Pastaj, ose do ta mbajmë, ose do ta heqim formulën. Po të hiqnim formulën, ne do të ballafaqoheshim me një ndarje pa formulë. Po të ruanim formulën, do të më falni, se nuk kam harruar që më keni thënë se ju kam thënë që në 2015-n nuk do të jetë formula, por ama 2015 është një përmbysje e madhe, një riorganizim thelbësor i pushtetit. Të bënim një formulë për tre muaj, 5 muaj, gjashtë muaj, dhe pastaj një tjetër. Do të ishte diçka që nuk shkon siç duhet. Ne me këtë formulë jemi përpjekur, me këto rregullime, që ju nuk i vlerësuat t'i bënit.

Po pse i kemi bërë këto rregullime, për të dhënë një përgjigje? Në fakt, ndoshta për të gjitha vërejtjet që lidhen me këtë çështje. Shpenzimet e pushtetit vendor në vitin 2015 janë të ndara, besoj gjysmë e gjysmë, por nuk e dimë se si do të jenë zgjedhjet, kur do të jenë zgjedhjet.

Në gjysmën e vitit ne do të kemi një pushtet në ikje dhe në gjysmën tjetër një pushtet – do të më falni, ai është i ardhur – por në ardhje nga ky aspekt që thatë edhe ju. Pra, edhe ne, duke qenë të ndërgjegjshëm, kemi vënë disa detyrime; që mbledhjen e parë pushteti i ri ta fillojë me buxhetin. Nisur edhe nga eksperiencia e qeverisë, është shumë e vështirë t'u

marrësh menjëherë dorën të gjitha investimeve dhe shpenzimeve, por sidomos investimeve: do të ndodhë që pushteti i vjetër nuk do të shohë për nga e ardhmja, për nga tre katër vitet e ardhme, por mund t'i çojë shpenzimet edhe atje ku nuk do të jenë tërësisht eficiente, ndërsa pushteti i ri do të harxhojë gjashtë muaj, katër muaj pa shpenzuar dot, sepse e ka të vështirë t'ia marrë dorën kësaj pune. Fillimisht do të merret me riorganizimin nga e para. Ne do të na ngelen investimet pa bërë. Dhe sa të na shuhet investimet, ne kemi gjetur Fondin e Zhvillimit Rajonal si një mundësi. Sipas vlerësimit të qeverisë – dhe do të kërkoja edhe mbështetjen tuaj për këtë – Fondi i Zhvillimit Rajonal gjatë vitit 2014 ka dhënë zgjidhje shumë të mira, sipas nesh, në mbështetje të komunitetit.

Pra, asnjëherë pushteti qendror nuk i ka marrë paret vetë, por i ka dhënë për zgjidhje, diku për zhvillim të qendrës së qytetit, për të marrë ngjyrimin e demokracisë, të njëzet viteve demokraci, dhe ka marrë rrugë, ambiente etj, që e kanë zhvilluar. Ka ndërruar, po synojnë ndryshimin e pamjes së qyteteve, por asnjëherë Fondi i Zhvillimit Rajonal nuk i ka marrë paratë për vete.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Fino, më fal, ju thashë se sipas vlerësimit të qeverisë, por gjykoj dhe gjej mbështetjen tuajm, të dyja palët jemi në një mendje: që ky fond e ka dhënë pozitivitetin e vet. Për veçoritë e vitit 2015 do të na duhet ta ruajmë këtë pozitivitet, si dhe për t'i dhënë mbështetje pushtetit lokal. Brenda kësaj, po ju them se mendohet të krijohet një njësi projektesh në qeveri, që t'ia bëjë gati pushtetit lokal dhe t'i thotë: ke ti projekte? M'i sill mua që të t'i bëj gati projektet, në mënyrë që të bëhen investimet sa më shpejt. Dhe kur pushteti lokal të jetë burim informacioni dhe kërkesash të panumërta për projekte, për investime, kjo njësi t'ia bëjë gati, ashtu siç është teknikisht.

Zoti Fino, të dy e njohim këtë gjuhë, sepse jemi marrë me këto projekte, projekte si nga ana teknike, ashtu edhe financiare. Atëherë këto projekte të gjejnë zhvillim dhe pushteti lokal të shkojë në përdorim të përsheptuar të të gjitha parave që do t'i jepen, doemos, sipas një projekti në rritje, siç ju thashë.

Tani, prania e pjesëtarëve të pushtetit lokal është vërtet një prani më e madhe e ministrave, por gjithnjë për të parë në raport me pushtetin lokal, por ata janë përfaqësues shoqatash të pushtetit lokal, në mënyrë që ata të jenë si zë cilësor në këtë fondin e zhvillimit rajonal. Natyrshëm që zëri i tyre duhet të jetë më i kualifikuar, për arsye se unë jam i pranishëm, siç edhe ma përmendët emrin, por vërejtja, sugjerimi i përhershëm ka qenë që, “duam projekte”, për shembull, pse nuk i është dhënë, supozojmë Tiranës projekt? Nuk ka projekt Tirana! Pra, Fondi i Zhvillimit Rajonal nuk mund të japë për një projekt që nuk është

paraqitur. Nuk e bën fondi projektin. Projektet merren nga fondi, konkurrohet, dhe merret vendimi për t'i dhënë drejtimin e duhur. Shoqatat e mbrojnë projektin, por duhet ta mbrojnë nëse është paraqitur. Në rastet kur është paraqitur, është bërë përzgjedhja e asaj që është gjykuar si më e mira. Zëri i tyre ka qenë i artikuluar dhe kjo është hapësira që i është dhënë.

Natyrisht, kuptohet, ka vende për përmirësime. Këto janë çështje në zhvillim. Ne themi se fondi i zhvillimit rajonal duhet parë më shumë nga produkti se sa nga përbërja. Nëse produkti ka qenë i mirë, ne jemi për mbështetjen e produktit.

(Diskutime pa mikrofon)

Një tjetër pyetje lidhet me qarkun. Po, është e vërtetë, në lidhje me qarqet është një sjellje tjetër. Viti 2015 ka një tjetër këndvështrim. Qarqet, ashtu siç thatë edhe ju, kanë problem për t'u tkurrur, për të parë vetveten. Ne do t'i zgjidhim problemet e komunitetit lokal, doemos duke u dhënë më shumë forcë bashkive, ashtu siç gjykoni ju, të cilat tashmë, me riorganizimin do të jenë shumë më të forta.

Mirë atëherë, po e mbyll këtu. Natyrisht ka vend edhe për përgjigje më të detajuara, por ju mirëkuptoj, se ndoshta edhe u zgjata. Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Besoj se këtu e mbyllim me pyetjet e me diskutimet, për shkak se edhe pyetjet ishin drejtuar edhe në formë diskutimesh, po edhe për shkak të faktit se në ditët në vijim do të kemi një sërë procedurash, që do ta shtjellojnë më tej si projektligjin e buxhetit ashtu edhe paketën fiskale, sipas edhe institucioneve, por edhe në parim e nen për nen.

Zoti Ministër, shumë faleminderit! Jo thjesht për prezencën, por mbi të gjitha për sqarimet e gjera, konkrete, të detajuara, siç thotë zonja Hysi. Përgjithësisht është një nga rastet e rralla që ka pasur një prezantim kaq të detajuar të ministrit të Financave në Komisionin e Ligjeve. Komplimente edhe për këtë gjë, edhe për juve edhe për stafin tuaj. Siç tha edhe zoti Fino, shpresoj se një pjesë e këtyre çështjeve që u trajtuan këtu nga kolegët, veçanërisht nga relatori, të trajtohen me më shumë vëmendje gjatë debatit që do të bëhet nen për nen, për të marrë përgjigje – edhe ju e latë të hapur – për të marrë të marrë disa përgjigje shumë më konkrete në bashkëbisedime dhe me institucionet e tjera, që në fund të fundit përbejnë mendimin kolegial të qeverisë, të sjellë nëpërmjet këtij dokumenti. E mbyllim këtu, besoj. Zoti Fino, e mbyllim? Po.

Faleminderit të gjithëve! Fundjavë të mbarë! Javën e ardhshme vazhdojmë përsëri me buxhetin, njëkohësisht me seancën dëgjimore me prokurorin e Përgjithshëm javën e ardhshme, por edhe me seancat dëgjimore për buxhetin.

Faleminderit!

MBLEDHJA MBYLLET